

VENDIM
Nr. 87, datë 20.4.2018

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURAVE PËR LIDHJET E REJA DHE
MODIFIKIMIN E LIDHJEVE EKZISTUESE ME RRJETIN E TRANSMETIMIT;
MARRËVESHJES SË OPERIMIT NË RRJETIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SHA
DHE PËRDORUESIT, SI DHE MARRËVESHJES SË LIDHJES NË RRJETIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SHA
DHE PËRDORUESIT**

Në mbështetje të neneve 16, 21, 27 dhe 28, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Kodit të Transmetimit”, miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të bordit të ERE-s dhe të nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, lidhur me miratimin e “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”,

konstatoi se:

Me shkresën nr. 2350 prot., datë 28.4.2017, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

- Në nenin 27, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se është OST sh.a., në cilësinë e të licencuarit, i ngarkuar me detyrimin e hartimit të kësaj rregulloreje dhe ERE ka autoritetin për miratimin e saj.

ERE, me vendimin nr. 83, datë 7.6.2017, filloi procedurën për miratimin e “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

- ERE, me shkresën nr. 100/27 prot. publikoi për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit, duke filluar nga data 10 qershor 2017, duke ftuar të gjitha palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre.

- Me shkresën nr. 458 prot., në datën 13.6.2017, ERE dërgoi “Draftrregullat e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

- Për marrje mendimi pranë subjekteve: OSHEE sh.a., KESH sh.a., Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Ekonomisë dhe Financës, Avokati i Popullit, si edhe prodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin e transmetimit.

- Pas përfundimit të afatit 15-ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 49 prot., datë 19.6.2017. “Alb-Energy” sh.p.k. bën me dije se draftrregullorja është hartuar konform ligjit, si dhe janë marrë në konsideratë edhe interesat e palëve, të cilat preken nga kjo rregullore dhe janë pjesë e marrëveshjeve me OST sh.a.

- Pas përfundimit të afatit 15-ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi, gjithashtu, se është paraqitur në ERE opinionin e Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 266/1 prot., datë 10.7.2017, i cili kërkon nga OST sh.a. sqarime mbi dispozitatë të kësaj rregulloreje.

- ERE organizoi një seancë dëgjimore në datën 22.11.2017, midis përfaqësuesve të Autoritetit të Konkurrencës dhe OST sh.a., për të diskutuar qëndrimet e palëve, duke lënë detyrë për OST-në, dërgimin e informacionit shpjegues pranë ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 228 prot., datë 2.3.2017, ka vënë në dijeni Autoritetin e Konkurrencës në lidhje me informacionin shpjegues të dërguar nga OST sh.a., me shkresën nr. 7211/1 prot., datë 28.2.2017, për të cilën nuk ka pasur komente nga e Autoriteti i Konkurrencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., si dhe palët e

interesuara për vendimmarrjen e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE

E PROCEDURAVE PËR LIDHJET E REJA DHE MODIFIKIMIN E LIDHJEVE EKZISTUESE ME RRJETIN E TRANSMETIMIT

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi dhe objekti

1.1.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të nevojshme për realizimin e një lidhje të re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese me rrjetin e transmetimit nëpërmjet një procesi që bazohet në respektimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe transparencës për të gjitha palët.

1.1.2 Kjo rregullore trajton procedurat për lidhjet e reja ose modifikimin e lidhjeve ekzistuese, metodologjinë e llogaritjes së kostove të lidhjes; marrëveshjen e lidhjes dhe tërësinë e detyrimeve reciproke në lidhje me afatet, kufijtë e pronësisë, pikës së matjes, shkëmbimin e informacionit, detyrimet financiare dhe kërkesat përkatëse teknike.

1.2 Baza ligjore dhe ndërvarësia

1.2.1 Kjo rregullore hartohet bazuar në nenet 21, 27 dhe 28, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

1.2.2 Kjo rregullore ka ndërvarësi, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në tërësi, si dhe në veçanti me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes.

1.3 Termat dhe përkufizimet

1.3.1 Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore duhet të kuptohen dhe interpretohen sikurse janë të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

1.3.2 Çdo term i përdorur në këto rregulla për të cilin nuk ekziston një përkufizim sipas pikës së mësipërme do të interpretohet në kontekstin dhe frymën e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

1.4 Mënyra e komunikimit

Si formë e përgjithshme komunikimi midis palëve do të jetë ajo me shkresë zyrtare. Gjatë hapave të ndryshëm të zbatimit të procedurave mund të pranohet edhe komunikimi me *e-mail* midis palëve, për efekt të shpejtësisë së komunikimit, e cila gjithsesi do të konsiderohet e vlefshme vetëm nëse shoqërohet me shkresë zyrtare.

2. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR LIDHJE TË RE OSE MODIFIKIM TË LIDHJES EKZISTUESE ME RRJETIN E TRANSMETIMIT DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

2.1 Parimet udhëzuese të procedurës së aplikimit

2.1.1 Kërkesa për lidhje të re ose modifikim të lidhjes ekzistuese me rrjetin e transmetimit paraqitet nga aplikuesi, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit/Kodit të Lidhjes, duke respektuar kërkesat dhe detyrimet në lidhje me afatet, dokumentacionin dhe kushtet teknike përkatëse.

2.1.2 Aplikuesi, i cili ka paraqitur aplikimin për lidhje të re ose modifikim të lidhjes ekzistuese do t'i ofrojë OST sh.a. të gjithë asistencën e nevojshme me të dhënat, sipas kërkesave të OST sh.a.

2.1.3 OST sh.a. do t'i sigurojë aplikuesit vlerësim të kostove për realizimin e lidhjes së kërkuar apo modifikimin e asaj ekzistuese sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, afateve për përpunimin e kërkesës dhe të realizimit të lidhjes me rrjetin dhe çdo informacion tjetër apo udhëzim të përshtatshëm, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe kësaj rregulloreje.

2.1.4 Aplikuesi dhe OST sh.a. realizojnë diskutime fillestare për lidhje ose modifikimin e mundshëm. Si pjesë e këtyre diskutimeve, OST sh.a. mund të ofrojë një vlerësim paraprak dhe të përkohshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes ekzistuese. Këto diskutime preliminare nuk do të formojnë në vete një aplikim dhe do të jenë nën një konfidencialitet të plotë.

2.2 Procesi dhe etapat e aplikimit

2.2.1 Aplikimi për lidhjen e re ose modifikim të lidhjes ekzistuese me rrjetin e transmetimit fillon me paraqitjen formale pranë OST sh.a. të formatit të aplikimit të përcaktuar në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje

dhe duhet të shoqërohet me dokumentacionin e përshkruar në mënyrë të detajuar në Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes.

2.2.2 Aplikuesi plotëson aplikimin duke iu referuar të dhënave standarde të planifikimit, sipas tabelave të shtojcës A, “Kategoritë dhe të dhënat e planifikimit”, të Kodit të Rrjetit të Transmetimit. Kur është e nevojshme nga pikëpamja teknike, OST sh.a. mund të përcaktojë kritere/kërkesa teknike shtesë nga ato të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, por në të gjitha rastet do të njoftojë palën tjetër brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në Kodin e Lidhjes.

2.2.3 Me marrjen e aplikimit, OST sh.a. kryen studimin e “Pranueshmërisë së lidhjes së re ose të modifikimit të lidhjes ekzistuese”, në rrjetin e sistemit të transmetimit. OST sh.a. shqyrton nëse dokumentet e depozituara dhe informacioni i paraqitur nga aplikuesi janë të plota dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. OST sh.a. i komunikon aplikuesit përgjigjen e tij për pranimin ose të refuzimit të aplikimit brenda 60 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të aplikimit.

2.2.4 Në rastet kur në aplikim mungon ndonjë nga dokumentet ose informacionet e parashikuara në këtë rregullore apo nëse OST sh.a. kërkon të dhëna apo informacion shtesë nga aplikuesi, sipas pikës 2.2.2, aplikuesi është i detyruar të paraqesë dokumentacionin e kërkuar, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit për plotësimin e tij. Në këtë rast, afati i pranimit apo i refuzimit të aplikimit, sipas pikës 2.2.3, bëhet 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të aplikimit.

2.2.5 Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumen-tacionin e kërkuar brenda periudhës së specifikuar në pikën 2.2.4, OST sh.a. refuzon aplikimin.

2.2.6 Me paraqitjen e gjithë informacionit të kërkuar nga OST sh.a., kjo e fundit në bazë të studimit të “Pranueshmërisë të lidhjes së re ose të modifikimit të lidhjes ekzistuese”, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 2.2.4:

a) I paraqet aplikuesit ofertën e lidhjes, duke përcaktuar pikë/vend lidhjeje ose zgjidhjen që teknikisht është më optimale dhe duke koordinuar teknikisht kërkesat për lidhje me rrjetin, të paraqitura nga aplikuesi të tjerë; ose

b) Në qoftë se, pas studimit të “Pranueshmërisë së lidhjes së re apo të modifikimit të lidhjes ekzistuese”, rezulton se zgjidhja optimale do të jetë lidhja në rrjetin e tensionit të mesëm, atëherë kërkesa për aplikim i kthehet zyrtarisht aplikuesit me këtë argumentim; ose

c) Në rast të një përgjigjeje negative, njofton aplikuesin për refuzimin e aplikimit, duke dhënë argumentimin përkatës për arsyet e këtij vendimi.

2.2.7 Aplikuesi, brenda 60 ditëve kalendarike nga marrja e ofertës së lidhjes, duhet të informojë zyrtarisht OST sh.a., për pranimin ose jo të saj nëpërmjet deklaratës së pranimit. Në rast se oferta e lidhjes, sipas germës “a” më sipër nuk pranohet nga aplikuesi ose aplikuesi nuk informon OST sh.a. brenda afatit kohor të caktuar, atëherë procesi i aplikimit për lidhjen rifillon nga e para.

2.2.8 Nëse aplikuesi e pranon ofertën e lidhjes, periudha kohore e vlefshmërisë të ofertës së lidhjes është 18 muaj nga marrja e ofertës së lidhjes nga aplikuesi. Në aplikimin e paraqitur në OST sh.a., përdoruesi i rrjetit duhet të ketë paraqitur periudhën kohore të ndërtimit dhe të energjizimit të objektit të tij.

2.2.9 Pas pranimit të ofertës për lidhje nga aplikuesi, në zbatim të studimit të “Pranueshmërisë së lidhjes së re apo të modifikimit të lidhjes ekzistuese” të kryer, OST sh.a. duhet të verifikojë, të shqyrtojë dhe të vlerësojë të gjithë aplikimin sipas kërkesave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit/Kodit të Lidhjes, sipas pikave më poshtë, por pa u kufizuar:

a) Të dhënat e aplikimit dhe të dokumentacionit të përgjithshëm dhe teknik të lidhjes të protokolluara;

b) Mundësinë për shfrytëzimin e kapacitetit të rrjetit të sistemit të transmetimit dhe nëse nuk ekziston kjo mundësi, aplikuesi do të marrë masa teknike dhe do të investojë vetë deri në mbulimin e plotë të investimit, brenda kushteve teknike të sigurisë të specifikuara në Kodin e Transmetimit dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;

c) Përcaktimin dhe përzgjedhjen e vendit të lidhjes së re në vendin e duhur, sipas shkallës së sigurisë së furnizimit, qëndrueshmërisë statike dhe dinamike, madhësive të lidhjeve të shkurtra 3- dhe 1-fazore, ndikimit në humbjet teknike në rrjetin e transmetimit me lidhjen e re dhe furnizimin me energji elektrike për nevojat vetjake, sidomos për rastet e lidhjes së njësisve gjeneruese;

d) Kostot e lidhjes së aplikuesit, konform neneve 27 dhe 28, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, sipas ofertës së lidhjes të konsultuar dhe të pranuar nga aplikuesi;

e) Plotësimin e të gjitha kushteve dhe standardeve teknike të pikëlidhjes dhe lidhjes teknike;

f) Zbatimin korrekt të dispozitave të Kodit të Transmetimit.

2.2.10 Aplikuesi, brenda 16 muajve nga marrja e ofertës së lidhjes nga OST sh.a., paraqet kërkesën për lidhjen e marrëveshjes së lidhjes sipas marrëveshjes tip të përcaktuar në këtë rregullore.

2.2.11 OST sh.a. dhe aplikuesi do të nënshkruajnë marrëveshjen e lidhjes, së bashku me anekset përkatëse, brenda 18 muajve nga marrja e ofertës së lidhjes, duke pasur në konsideratë kushtet dhe kërkesat teknike.

3. TIPAT E LIDHJES SË RE OSE TË MODIFIKIMIT TË LIDHJES EKZISTUESE

3.1 Tipat e lidhjes së re ose të modifikimit të lidhjes ekzistuese me rrjetin e transmetimit janë:

a) Lidhje ose modifikim standard - lidhja e re ose modifikimi i lidhjes ekzistuese nëpërmjet aseteve të lidhjes, në rrjetin e transmetimit, pa kryer ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose për përmirësimin e operimit të rrjetit, për të përmbushur pajtueshmërinë me Kodin e Rrjetit të Transmetimit;

b) Lidhje ose modifikim i përforcuar - lidhja e re ose modifikimi i lidhjes ekzistuese, kur përveç aseteve të lidhjes kërkohen edhe investime shtesë apo ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose për përmirësimin e operimit të rrjetit, për të përmbushur pajtueshmërinë me Kodin e Rrjetit të Transmetimit;

c) Lidhje ose modifikim jostandard - lidhja e re ose modifikimi i lidhjes ekzistuese që nuk përbën asnjë nga rastet e parashikuara në germet “a” dhe “b” të kësaj pike, por që kërkon kushte të veçanta të trajtimit nga OST sh.a.

3.2 Kategorizimi i aplikimit për lidhje apo për modifikim të lidhjes, si standard, i përforcuar apo jostandard, do të bëhet bazuar dhe në referencë të bazës së aseteve të rregulluara të OST sh.a. të njohura nga ERE.

3.3 Lidhja e re ose modifikimi i lidhjes ekzistuese e cila nuk është koordinuar me planin afatgjatë dhe afatmesëm të zhvillimit të rrjetit dhe planin e investimeve të miratuar nga ERE, do të konsiderohen si lidhje e përforcuar.

3.4 Lidhja e re ose modifikimi i lidhjes ekzistuese me rrjetin e transmetimit, pavarësisht nga tipi (standard/e përforcuar/jostandard) mund të realizohet (në të njëjtën kohë apo dhe në kohë të ndryshme) dhe do të konsiderohet si lidhje e përbashkët kur dy apo më shumë përdorues përdorin këtë lidhje. Në këtë rast, kostot për realizimin e lidhjes ose të modifikimit të lidhjes, përfshirë përforsimet apo përmirësimet në rrjetin e transmetimit dhe kostot për mirëmbajtjen dhe riparimin, përpjesëtohen mes përdoruesve në funksion të fuqisë së instaluar, projektit teknik, pikës së lidhjes dhe projektzbatimit përfundimtar, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, ndërsa tarifat sipas paragrafit 4.6 paguhën nga secili prej përdoruesve.

3.5 Ilustrime shpjeguese të tipave të lidhjes paraqiten në shtojcën 3 të kësaj rregulloreje.

4. METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË KOSTOVE DHE TË TARIFAVE PËR LIDHJEN E RE OSE MODIFIKIMIN E LIDHJES EKZISTUESE

4.1 Parimet e identifikimit dhe të përlllogaritjes së kostove të lidhjes së re ose të modifikimit të lidhjes ekzistuese dhe të mirëmbajtjes së lidhjes

4.1.1 Për qëllim të kësaj rregulloreje, identifikimi i kostove të lidhjes dhe të mirëmbajtjes, të riparimit dhe të operimit të lidhjes apo të modifikimeve përkatëse do të marrë në konsideratë dhe do të reflektojë kushtet reale të sistemit, për sa i përket nivelit të humbjeve në rrjet, kapacitetit të kufizuar në pjesë të veçanta të tij apo që mund të shkaktohet nga lidhjet e reja apo modifikimi i atyre ekzistuese, kostot e nevojshme të investimeve infrastrukturore që mundësojnë lidhjen me rrjetin, kostot përkatëse administrative të shqyrtimit, ndjekjes dhe finalizimit të procedurës të lidhjes së re apo të modifikimit të asaj ekzistuese, si dhe kostot për mirëmbajtjen dhe riparimin (mirëmbajtja e skedular/preventive/ korrektuese) e lidhjes.

4.1.2 Në të gjitha rastet, identifikimi i kostove do të marrë në konsideratë:

- a) Qëllimin e lidhjes apo të modifikimit;
- b) Statusin e përdoruesit (ekzistues/i ri);
- c) Pika e lidhjes së synuar dhe kapacitetin e përdoruesit;
- d) Profilet e gjenerimit/të konsumit;
- e) Kostot për përforsimin ose për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose për përmirësimin e operimit të rrjetit, përfshirë shpronësimet kur është e nevojshme;
- f) Menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e lidhjes; si dhe
- g) Karakteristika të tjera që nevojiten për lidhjen.

4.1.3 Kostot identifikohen dhe përlllogariten, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin elektrik, në përputhje me nenin 34, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, standardet teknike në fuqi; përmbledhësen e legjisllacionit ndërtimor, veçanërisht, “Manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (të përditësuar) dhe situacionet e realizimit të punimeve, duke pasur referencë dhe kufi maksimal koston e përafërt të vlerësuar nga OST sh.a., sipas procedurave të vlerësimit për projekte të ngjashme të realizuara për llogari të saj.

4.1.4 Identifikimi i kostove sipas kësaj rregulloreje, ndër të tjera ka për qëllim të inkurajojë përdoruesit për të ndarë asetet e lidhjes kur është e mundur teknikisht, duke nxitur eficiencën ekonomike dhe teknike në

sigurimin e aseteve dhe mbulimin e kostove të cilat mund të realizohen dhe të përballohen bashkërisht ndërmjet përdoruesve.

4.2 Kostot për lidhje ose për modifikime, standarde ose të përforcuara

4.2.1 Kostot për lidhjet ose modifikimet standarde ose të përforcuara, në përputhje me dispozitat e paragrafit 4.1, pika 4.1.3, pa u kufizuar, përfshijnë:

- a) Kostot për studimin e fizibilitetit (investigimi, vlerësimi i burimeve, vlerësimet mjedisore);
- b) Kostot për zhvillimin e projektit (negocimi, lejet dhe autorizimet, financimi, menaxhimi i projektit);
- c) Kostot e inxhinierisë (studimet teknike, projektimi, tenderimi, kontraktimi, transporti, ndërtim-instalimi i pajisjeve, përfshirë sistemet e menaxhimit, trajnimi, supervizimi, komisionimi dhe transferimi);
- d) Kosto të tjera të nevojshme për lidhjen me sistemin e transmetimit.

4.3 Kostot për lidhjet ose modifikimet jostandarde

4.3.1 OST sh.a. do të identifikojë, rast pas rasti, kostot që shoqërojnë lidhjen në rrjet ose modifikimin e lidhjes ekzistuese me kushte të veçanta të pikës së lidhjes, duke përcaktuar kosto që do t'i ngarkohen përdoruesit.

4.3.2 OST sh.a. do të identifikojë, rast pas rasti, kostot dhe përfitimet që shoqërojnë rrethanat e veçanta të prodhuesve të ndodhur në zona të largëta dhe zona me dendësi të ulët të popullsisë.

4.3.3 Në kuptim të pikës 4.3.2 më sipër, OST sh.a., krahas përlogaritjes së kostove sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, kur e vlerëson të nevojshme dhe të arsyeshme mund të kryejë edhe një analizë kosto-përfitim, në lidhje me aplikimin e paraqitur, si vijon:

a) Analiza kosto-përfitim mund kryhet duke zbatuar një ose disa prej parimeve llogaritëse si vijon:

- i) NPV;
- ii) ROI;
- iii) IRR;
- iv) BEP.

b) Përfitimet sasiore do të përfshijnë:

i) Përmirësimin e sigurisë së furnizimit, reduktimin e kohëzgjatjes së ndërprerjes së furnizimit dhe reduktimin e kostove shoqërore gjatë kohës së ndërprerjes të furnizimit;

ii) Mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, shkëmbimet ndërkufitare dhe integrimin e burimeve të rinovueshme;

iii) Qëndrueshmërisë së frekuencës, rezervave, sigurimit të energjisë reaktive, menaxhimit të konxhestioneve dhe masat e mbrojtjes.

4.4 Kostot e mirëmbajtjes së aseteve të lidhjes

4.4.1 Kostot e mirëmbajtjes për asetet e lidhjes sipas projektzbatimit përfundimtar identifikohen në mënyrë analitike, sipas parimeve të përcaktuara në paragrafin 4.1 dhe përlogariten në bazë vjetore në masën 2% të vlerës fillestare investimit të lidhjes, përfshirë investimet shtesë apo ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose për përmirësimin e operimit të rrjetit përgjatë gjithë jetëgjatësisë së aseteve të lidhjes.

4.4.2 Kostot e mirëmbajtjes do të fillojnë të paguhet nga përdoruesi menjëherë pas përfundimit të garancisë teknike të aseteve të lidhjes, por jo më shumë se 12 muaj nga vënia në punë e tyre, në përputhje me marrëveshjen e mirëmbajtjes që do të lidhet midis OST sh.a. dhe përdoruesit.

4.5 Mbulimi i kostove të lidhjes së re ose të modifikimit të lidhjes ekzistuese dhe të mirëmbajtjes

4.5.1 Në të gjitha rastet kostot për lidhjen ose për modifikimin e saj me rrjetin e transmetimit përballohen nga aplikuesi.

4.5.2 Për rastet kur lidhja ose modifikimi i lidhjes me sistemin e transmetimit realizohet nga OST sh.a., kostot e identifikuar sipas pikës 4.5.4, i parapaguhet OST sh.a. nga aplikuesi.

4.5.3 Në rastin e mungesës së kapaciteteve të nevojshme për lidhjen ose të modifikimit të përforcuar të lidhjes në sistemin e transmetimit, aplikuesi do të përballojë kostot për përmirësimin e sistemit të transmetimit, bazuar në një marrëveshje mes palëve, sipas pikës 5.2.

4.5.4 Në rastin e lidhjeve të përbashkëta, përdoruesit mbulojnë kostot e lidhjes dhe kostot e mirëmbajtjes dhe të riparimit, në mënyrë proporcionale, me fuqinë e instaluar dhe kompleksitetin e lidhjes, në funksion të pikës së lidhjes, sipas vlerësimit të OST sh.a.

4.5.5 Në rastin e një lidhjeje të përbashkët apo kur një aplikues i ri, bazuar në kushtet teknike të rrjetit, me autorizim të OST sh.a., lidhet në sistemin e transmetimit nëpërmjet aseteve të lidhjes së re të realizuar nga një përdorues ekzistues (aplikues i mëparshëm), i paguan këtij të fundit kompensimin e drejtë të kostove për investimin e kryer, bazuar në parashikimet e kësaj rregulloreje. Përdoruesi i ri dhe ai ekzistues do të bien dakord në lidhje me të drejtat e pronësisë së aseteve të lidhjes.

4.5.6 Vlera e kompensimit do të llogaritet si vijon:

$$V_{\text{komp.}} = (V_{\text{Invest.}} - V_{\text{amort.kom.}}) \times \frac{P_{\text{inst.perd.}}}{P_{\text{efekt.}}}$$

$V_{\text{komp.}}$ - Vlera e kompensimit në lekë.

$V_{\text{invest.}}$ - Vlera e investimit fillestar të lidhjes, përfshirë investimet shtesë apo ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose për përmirësimin e operimit të rrjetit.

$V_{\text{amort.kom.}}$ - Vlera kumulative e amortizimit vjetor sipas normave fiskale në lekë.

$P_{\text{inst.perd.}}$ - Fuqia e instaluar e përdoruesit të ri në mw.

$P_{\text{efekt.}}$ - Kapaciteti efektiv i rrjetit në pikën e lidhjes në mw pas kryerjes së investimit fillestar

4.5.7 Kostot për mirëmbajtjen dhe riparimin sipas paragrafit 4.1 dhe 4.4, i parapaguhet OST sh.a. nga përdoruesi ose nga përdoruesit, në mënyrë proporcionale, në rastin e lidhjeve të përbashkëta, në bazë vjetore dhe si është e përshtatshme apo sipas kërkesës së OST sh.a., në rastet kur kërkohet një ndërhyrje për riparim apo për korrektim të lidhjes.

4.5.8 OST sh.a. do të lidhë marrëveshjen e lidhjes, pasi palët të kenë paraqitur në OST sh.a. marrëveshjen që rregullojnë çështjet e parashikuara nga pikat 4.5.5–4.5.7 e këtij paragrafi.

4.5.9 Asetet e dëmtuara në mënyrë të parikuperueshme, zëvendësohen me asete të reja. Pavarësisht nga pagesat për kostot e mirëmbajtjes, kostot e zëvendësimit me asete të reja përballohen nga përdoruesi ose përdoruesit e përbashkët, në përputhje me marrëveshjen e parashikuara në pikën 4.5.8.

4.6 Tarifat e lidhjes

4.6.1 Tarifat e lidhjes do të aplikohen nga OST sh.a. për të gjitha aplikimet e paraqitura për një lidhje të re ose modifikim të një lidhjeje ekzistuese, me qëllim mbulimin e kostove administrative të OST sh.a., për shqyrtimin, për ndjekjen dhe për finalizimin e procedurës së lidhjes së re apo të modifikimit të asaj ekzistuese.

4.6.2 Tarifat e lidhjes paguhet individualisht nga aplikuesi në rastin e lidhjeve të përbashkëta.

4.6.3 Tarifat e lidhjes konsistojnë në:

a) Tarifa për aplikim (tarifa për mbulimin e kostove të studimit të pranueshmërisë së lidhjes ose të modifikimit të saj në rrjetin e transmetimit, përgatitjes së dokumentacionit për marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin apo amendimeve të nevojshme). Kjo tarifë është fikse dhe do të paguhet në vlerën 500,000.00 lekë, në momentin e aplikimit nga përdoruesi.

b) Tarifa për mbikëqyrje (tarifa për mbulimin e kostove për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikëqyrjen e ndërtimit, testimit dhe komisionimit të lidhjes/të modifikimit). Kjo tarifë do të jetë variabël, në funksion të fuqisë së plotë të kërkuar, të deklaruar nga përdoruesi dhe do të ketë vlerën 50 lekë/kVA, por në të gjitha rastet nuk do të jetë më e madhe se vlera kufi prej 2,500,000.00 lekësh. Pagesa e kësaj tarife bëhet nga aplikuesi në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes së lidhjes apo të amendimit të saj në rastin e lidhjeve ekzistuese dhe është parakusht për nënshkrimin e marrëveshjes.

4.6.4 OST sh.a. do të publikojë në faqen e saj në *web* vlerën aktuale të tarifës së aplikimit dhe të tarifës për mbikëqyrjen.

4.6.5 Pagesa e tarifave të lidhjes kryhet me transfertë bankare, sipas përlogaritjes së OST sh.a. bazuar në përcaktimet e mësipërme dhe është e pakthyeshme në çdo rrethanë.

5. LIDHJA ME RRJETIN E TRANSME-TIMIT, ANULIMI DHE DE-ENERGJIZIMI

5.1 Marrëveshja tip e lidhjes

5.1.1 Midis palëve do nënshkruhet marrëveshja e lidhjes sipas marrëveshjes tip. Në marrëveshjen e lidhjes duhet të specifikohen kushtet e përgjithshme të lidhjes dhe çdo kusht specifik teknik dhe financiar i aplikuar në atë lidhje, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/ Kodin e Lidhjes, Kodin e Matjes dhe këtë rregullore, në lidhje me kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, operimin, përgjegjësitë për sigurinë e personelit, kufijtë e pronësisë, pikat e matjes etj.

5.1.2 Përveç sa më sipër, marrëveshja e lidhjes do të detajojë kërkesa teknike dhe operacionale për përdoruesit në lidhje me kontraktimin e operatorëve të licencuar për kryerjen e punimeve të nevojshme për lidhjen me rrjetin e transmetimit, me qëllim garantimin e sigurisë në punë, sigurisë së operimit, cilësisë dhe standardeve të realizimit të projektit.

5.1.3 Modifikimi i lidhjeve ekzistuese do të shoqërohet në çdo rast me amendimet eventuale të marrëveshjes tip të lidhjes, të cilat reflektojnë situatën e re teknike, financiare dhe pronësore.

5.2 Marrëveshja për përmirësimin e sistemit

5.2.1 Në rast mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e përdoruesve të rinj, krahas marrëveshjes së lidhjes, OST sh.a. mund të hyjë në marrëveshje me palën kërkuese për përmirësimin e sistemit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, me kusht që kostot të përballohen nga pala kërkuese. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ERE, pas propozimit nga OST sh.a.

5.2.2 Kjo marrëveshje do të specifikojë në mënyrë të detajuar çështjet që lidhen me kostot e përmirësimit të sistemit apo çështje të tjera.

5.2.3 E njëjta praktikë do të ndiqet në rastet e modifikimit të lidhjes ekzistuese, e cila shoqërohet me nevojën e përforsimit dhe të përmirësimit të rrjetit dhe rritjen e kapaciteteve të nevojshme.

5.2.4 Në çdo rast, marrëveshja përkatëse amendohet duke reflektuar situatën e re teknike, financiare dhe pronësore.

5.3 Pajtueshmëria dhe njoftimet operacionale

5.3.1 Në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodit të Lidhjes, rregulloren dhe marrëveshjen e lidhjes përkatëse, sipas detajimit dhe afateve të kërkuara në marrëveshje, aplikuesi është i detyruar të paraqesë një raport periodik dhe një certifikatë finale performance të infrastrukturës së tij lidhëse me rrjetin e transmetimit, duke shpjeguar përmbushjen në terma sasiorë dhe cilësorë të kërkesave teknike dhe kriterëve operacionale të specifikuar në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, si dhe të kërkesave shtesë të parashikuara me ligj, marrëveshjeve bilaterale dhe/ose siç kërkohet nga OST sh.a.

5.3.2 Procedura operative e njoftimi për lidhje për çdo përdorues kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të *Commission Regulation (EU) 2016/631* dhe [NC DC] dhe detajohet si vijon:

- a) Njoftimi Operacional i Energjizimit (EON);
- b) Njoftimi Operacional i Ndërmjetëm/i Përkohshëm (ION);
- c) Njoftimi Operacional Final (FON); dhe
- d) Njoftimi Operacional i Kufizuar (LON).

5.3.3 Përdoruesi do të ofrojë asistencën dhe gjithë informacionin e nevojshëm për OST sh.a., për të mbledhur të dhëna, për të verifikuar përmbushjen e kërkesave teknike dhe të performancës.

5.3.4 Rekomandohet që përdoruesi të këshillohet dhe të kontrollojë me OST sh.a. çështje relevante, në një fazë të hershme të projektit, në mënyrë që të mundësohen korrigjimet e nevojshme para se projekti i realizimit të lidhjes/i modifikimit t'i nënshtrohet verifikimit të pajtueshmërisë së plotë për efekt të komisionimit dhe energjizimit final të lidhjes.

5.3.5 Grupi përkatës i komisionimit të lidhjes së re apo të modifikimit të lidhjes ekzistuese, bashkë me njoftimeve operacionale, harton edhe lejen teknike për lidhjen e re ose për modifikimin, e cila përmban tërësinë e dokumentacionit teknik të përshkruara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit /Kodin e Lidhjes. Marrëveshja standarde e lidhjes është dokument përbërës i lejes teknike të lidhjes.

5.4 Lidhjet emergjente

5.4.1 Në raste e rrethana të paparashikuara është e nevojshme të sigurohet lidhje emergjente në rrjetin e transmetimit. Në këtë rast lidhja do të kryhet me kusht që:

- a) Aplikuesit i miratohet një pezullim i përkohshëm, sipas procedurave në Kodin e Rrjetit të Transmetimit;
- b) Aplikuesi paguan tarifat e lidhjes sipas paragrafit 4.6 dhe çdo kosto tjetër në kuptim të paragrafit 4.5.

5.5 Anulimi (përfundimi) i lidhjes dhe de-energizimi

5.5.1 Kur një përdorues dëshiron të anulojë lidhjen elektrike me rrjetin e transmetimit dhe të përfundojë marrëveshjen e lidhjes, ai duhet të njoftojë OST sh.a. 3 muaj përpara. OST sh.a. ka të drejtë të kalojë në pronësi të saj pa pagesë të gjitha asetet që kanë funksionin e transmetimit.

5.5.2 De-energizimi i lidhjes nuk do të konsiderohet si përfundim i marrëveshjes së lidhjes.

6. PRONËSIA E ASETEVE DHE AKSESI

6.1 Kufijtë e pronësisë midis rrjetit të transmetimit dhe të përdoruesit të sistemit dhe aksesit në asetet përkatëse, përcaktohen sipas dispozitave të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe Kodit të Rrjetit dhe janë pjesë përbërëse e marrëveshjes së lidhjes, të detajuara dhe shoqëruara me përshkrim dhe paraqitjen e nevojshme dhe të përshtatshme grafike.

6.2 Prodhuesit që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike.

6.3 Pronësia e aseteve të lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues është e përdoruesit, deri në amortizimin e plotë të aseteve apo në përfundimin e autorizimit të dhënë, bazuar në marrëveshjen e lidhjes të nënshkruar ndërmjet palëve. Pas amortizimit të plotë të aseteve të lidhjes, pronësia e tyre i kalon pa kundërshtim OST sh.a.

6.4 OST sh.a., bazuar në kushtet teknike të rrjetit, autorizon lidhjen e një përdoruesi të ri në sistemin e transmetimit, nëpërmjet aseteve të lidhjes së re, të realizuar nga një përdorues i mëparshëm kundrejt kompensimit sipas vlerësimeve të OST sh.a., në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

6.5 Në rastin kur OST sh.a. vlerëson rëndësinë që kanë asetet e lidhjes, në zhvillimin e sistemit të transmetimit apo të shpërndarjes apo kur këto asete i shërbejnë më shumë se një klienti, ka të drejtën e marrjes në pronësi të një pjese ose të të gjithë lidhjes së ndërtuar nga ana e përdoruesit, sipas legjislacionit

civil, kundrejt një kompensimi të plotë të kostove të llogaritura, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe këtë rregullore, duke marrë në konsideratë dhe amortizimin teknik dhe financiar të aseteve të lidhjes.

6.6 Në të gjitha rastet e transferimit të pronësisë procedohet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

7. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

7.1 Të gjithë aplikuesit do të trajtohen në baza jodiskriminuese, përveç nëse ka arsye të mirëfillta teknike për dallime.

7.2 I gjithë komunikimi ndërmjet një aplikuesi dhe OST sh.a. është tërësisht konfidencial. OST sh.a. nuk do të diskutojë çështjet me palët e treta, përveç nëse lejohet me shkrim nga përdoruesi dhe në rastet kur kërkohet nga ligjet në fuqi.

7.3 Cilido aplikues ka të drejtë të ankohet në ERE për refuzimin për lidhje dhe për çdo mosmarrëveshje tjetër me OST sh.a., në lidhje me këtë rregullore.

7.4 Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi, me vendim të bordit të ERE-s, në përputhje me rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s.

7.5 Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

8. DISPOZITA KALIMTARE

Çdo aplikim i bërë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të trajtohet sipas dispozitave të “Udhëzuesit për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo të modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a.”, miratuar nga ERE me vendimin nr. 2, datë 10.1.2011.

SHTOJCA 1

“Analizë sasiore kosto-përfitim”, analiza e një situatë, ngjarjeje apo alternative, veçanërisht një propozimi, me anë të modelimit, komplekse teknike, matematikore dhe statistikore.

“Anulimi”, akti i përfundimit mes palëve të marrëdhënies së rregulluar nga marrëveshja e lidhjes. Përfundimi i marrëveshjes së lidhjes do të trajtohet në vetë marrëveshjen e lidhjes.

“Aplikim”, një kërkesë formale duke respektuar formën dhe afatet, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe apo modifikimin e lidhjes ekzistuese, përfshirë dhe/apo për shkak të ndryshimeve në kapacitetin generues apo të ngarkesës.

“Aplikues”, subjekti përdorues, ekzistues ose potencial që kryen aplikimin për lidhje të re ose modifikim të lidhjes ekzistuese me rrjetin e transmetimit.

“Asete e lidhjes”, tërësia e impianteve dhe e pajisjeve të instaluar ose që do të instalohen për të realizuar lidhjen e përdoruesit me rrjetin e transmetimit apo do të modifikohen në rastin e përdoruesve ekzistues, në përputhje me ofertën e lidhjes, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit/Kodit të Lidhjes.

“Baza e aseteve të rregulluara”, tërësia e linjave, nënstacioneve, ndërtesave të shërbimit, impianteve dhe pajisjeve të instaluar të njohura nga ERE si asete të OST sh.a. dhe të cilat janë marrë në konsideratë në procesin e llogaritjes dhe të miratimit të tarifës së transmetimit të energjisë elektrike.

“De-energizimi”, akti fizik i ndarjes/shkyçjes së sistemeve/të objekteve të përdoruesve të rrjetit të transmetimit nga rrjeti i transmetimit pa përfunduar marrëdhënien ligjore mes palëve.

“Dokumentacioni”, tërësia e të dhënave, studimeve, projekteve teknike dhe grafike, llogaritjeve, lejeve apo autorizimeve nga të tretë, të cilat kërkohen dhe shoqërojnë aplikimin.

“Kostoja e përafërt”, vlerësimi sasior paraprak i kostove të lidhjes, bazuar në procedurat e brendshme të OST sh.a. dhe në të dhënat nga projekte të ngjashme.

“Kostot e mirëmbajtjes dhe të riparimit”, kostot e realizimit të ndërhyrjeve preventive periodike dhe/apo korrigjuese për mbajtjen e impianteve dhe pajisjeve në gjendje të mirë pune, në përputhje me standardet dhe kërkesat teknike dhe të sigurisë.

“Kufijtë e pronësisë”, ndarja ligjore dhe pronësore ndërmjet rrjetit të transmetimit dhe përdoruesit dhe/apo ndërmjet përdoruesve në rastet e lidhjeve të përbashkëta.

“Lidhje emergjente”, lidhja e një përdoruesi në kushtet e pezullimit të përkohshëm sipas procedurave të rrjetit të transmetimit.

“Lidhje/modifikim i përforcuar”, modifikimet e lidhjeve ekzistuese apo lidhjet e reja të përdoruesve kur, përveç aseteve të lidhjes kërkohen edhe investime shtesë apo ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose për përmirësimin e operimit të rrjetit për të përmbushur pajtueshmërinë me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

“Lidhje/modifikim jostandard”, modifikimet e lidhjeve ekzistuese apo lidhjet e reja në kuptim të paragrafit 4.3.

“Lidhje/modifikim standard”, modifikimet e lidhjeve ekzistuese apo lidhjet e reja të përdoruesve,

nëpërmjet aseteve të lidhjes në rrjetin e transmetimit, pa kryer ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose për përmirësimin e operimit të rrjetit, për të përmbushur pajtueshmërinë me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

“Manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, buletini periodik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe i analizave teknike të çmimeve, i detyrueshëm për zbatim, sipas pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 15.8.2007. Buletini përditësohet çdo vit me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

“Marrëveshja për përmirësimin e sistemit”, marrëveshje ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, e propozuar nga OST sh.a. dhe e miratuar nga ERE, me objekt përmirësimin e sistemit dhe rritjen e kapaciteteve, në mënyrë të tillë që mundësojnë lidhjen e përdoruesit në rrjet.

“Marrëveshja standarde e lidhjes 7”, marrëveshja ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të rrjetit për lidhjen në rrjetin e transmetimit konform kushteve dhe kërkesave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

“Marrja në pronësi”, transferimi i të drejtave dhe i detyrimeve ligjore dhe pronësore nga një palë tek një tjetër nëpërmjet praktikave të njohura dhe të përcaktuara nga kuadri ligjor përkatës.

“Njoftimi operacional final”, njoftimi i lëshuar nga OST sh.a. për përdoruesin i cili përmbush specifikimet dhe kërkesat përkatëse, duke lejuar ata të operojnë duke përdorur lidhjen e rrjetit.

“Njoftimi operacional i energjizimit 8”, njoftimi i lëshuar nga OST sh.a. për përdoruesin para energjizimit të rrjetit të tij të brendshëm.

“Njoftimi operacional i ndërmjetëm 8”, njoftimi i lëshuar nga OST sh.a. për përdoruesin i cili u lejon atyre të operojnë impiantet dhe pajisjet e tyre, duke përdorur lidhje me rrjetin për një kohë të kufizuar dhe për të filluar testet e pajtueshmërisë për të siguruar përputhshmërinë me specifikimet dhe kërkesat përkatëse.

“Njoftimi operacional i kufizuar”, njoftimi i lëshuar nga OST sh.a. për përdoruesin i cili kishte arritur më parë statusin FON, por që është përkohësisht objekt ose i një modifikimi të rëndësishëm, ose i humbjes së aftësive që rezulton në mospërputhshmëri me specifikimet dhe kërkesat përkatëse.

“Majftueshmëria”, deklaratat/dokumenti i paraqitur nga përdoruesi i ri ose ekzistues për OST sh.a. ku deklarohet statusi aktual i pajtueshmërisë me specifikimet dhe kërkesat përkatëse, sipas ofertës së lidhjes dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

“Pika e matjes”, pika e matjes tregtare do të jetë gjithmonë në anën e tensionit të lartë të transformatorit të fuqisë (transformatorit lidhës me rrjetin e transmetimit), sipas specifikimeve të Kodit të Matjes.

“Përdorues”, personat fizikë ose juridikë që janë të lidhur me rrjetin e transmetimit dhe që operojnë njësi gjeneruese, ngarkesa apo rrjetë shpërndarjeje të energjisë elektrike.

“Përmbledhëse e legjislacionit ndërtimor”, përmbledhje e kuadrit ligjor përkatës për sektorin, botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

“Plani i investimeve”, plani i investimeve në rrjetin e transmetimit, i hartuar nga OST sh.a. dhe i miratuar nga ERE.

“Plani i zhvillimit afatgjatë”, plani i hartuar nga OST sh.a. dhe i miratuar nga ERE, në lidhje me planifikimin e nevojave për investime në kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse në baza afatgjata, me qëllim përmbushjen e kërkesës për energji elektrike dhe sigurinë e furnizimit të pandërprerë të klientëve të energjisë elektrike.

“Projektzbatimi përfundimtar”, tërësia e dokumentacionit teknik të përgatitur nga përdoruesit dhe të pranuar nga OST sh.a., i cili paraqet ndryshimet në vend në krahasim me dokumentacionin origjinal të ndërtimit të aseteve të lidhjes.

[NC DC], Kodi për Lidhjen e Ngarkesës i ENTSO-E.

[COMMISSION REGULATION (EU) 2016/631 of 14 April 2016 establishing a network code on requirements for grid connection of generators] - Rregullore e Komisionit Evropian për vendosjen e Kodit të Rrjetit në kërkesat për lidhje të gjeneratorëve.

“Oferta e lidhjes”, komunikimi/përgjigjja zyrtare e OST sh.a. për aplikuesin, me vlefshmëri kohore të limituar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, në lidhje me aplikimin e paraqitur për lidhje apo modifikim të lidhjes ekzistuese dhe që përmban udhëzimet relevante dhe identifikimin e çdo detyrimi reciprok të palëve, si dhe informacionin e nevojshëm teknik për realizimin e lidhjes ose të modifikimit.

SHTOJCA 2
FORMATI I APLIKIMIT PËR PËRDORUES/NGARKESË

Aplikuesi	
Personi i kontaktit	
Informacioni i kontaktit i aplikuesit	
Lloji i aplikimit <i>Specifiko: A) lidhje e re; B) modifikimi i lidhjes ekzistuese. Nëse "B", përskruaj modifikimin e kërkuar.</i>	
Vendndodhja e propozuar e nënstacionit <i>Bashkëngjijtë paraqitjen grafike/ hartën.</i>	
Data e kërkuar e përfundimit	
Numri i propozuar i transformatorëve <i>Bashkëngjijtë skemën e planimetrisë së propozuar të nënstacionit.</i>	
Ngarkesa maksimale për t'u furnizuar (mw) brenda 10 viteve nga koha e lidhjes	
Faktori maksimal i ngarkesës induktive dhe i ngarkesës kapacitive	
Pala përgjegjëse për lidhjen	
Paraqitje e informacionit relevant teknik sipas kërkesave në Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes	
Paraqitje e informacioneve të tjera relevante të cilat do të ndihmojnë në shqyrtimi e aplikimit	
Tarifa e lidhjes <i>Transferta bankare në llogari të OST sh.a.</i>	

Unë i poshtëshënuari konfirmoj se të gjitha informacionet e paraqitura më lart janë të sakta në bazë të njohurisë sime më të mirë. Unë do të njoftoj OST sh.a. për çfarëdo ndryshimi të këtyre të dhënave sa më parë që të jem në dijeni për ndryshime relevante.

Emri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Formati i aplikimit për përdorues/gjenerues

Aplikuesi	
Personi i kontaktit	
Informacioni i kontaktit i aplikuesit	
Lloji i aplikimit <i>Specifiko: A) lidhje e re; B) modifikimi i lidhjes ekzistuese. Nëse "B", përskruaj modifikimin e kërkuar.</i>	
Vendndodhja e propozuar e nënstacionit <i>Bashkëngjijtë paraqitjen grafike/ hartën.</i>	
Data e kërkuar e përfundimit	
Fazat e projektit <i>Bashkëngjijtë detajet e planit kobar.</i>	
Nëse është TEC, lloji i lëndës djegëse	
Nëse është HEC, bashkëngjijtë detajet e plota hidrologjike	
Nëse është EOLIKE, bashkëngjijtë informacionet meteorologjike	
Nëse është PHV, bashkëngjijtë informacionet mbi rrezatimin kwh/m ² /d	
Numri i propozuar i gjeneratorëve/i paneleve dhe madhësitë (Mw) <i>Bashkëngjijtë skemën e planimetrisë së nënstacionit.</i>	
Gjenerimi maksimal (Mw)	
Gjenerimi maksimal i qëndrueshëm (Mw)	
Maksimumi MVA dhënie dhe MVA marrje	
Pala përgjegjëse për lidhjen	
Paraqitje e informacionit relevant teknik sipas kërkesave në Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes	
Paraqitje e informacioneve të tjera relevante të cilat do të ndihmojnë në shqyrtimin e aplikimit	
Tarifa e lidhjes <i>Transferta bankare në llogari të OST sh.a.</i>	

Unë i poshtëshënuari konfirmoj se të gjitha informacionet e paraqitura më lart janë të sakta në bazë të njohurisë sime më të mirë. Unë do të njoftoj OST sh.a. për çfarëdo ndryshimi të këtyre të dhënave sa më parë që të jem në dijeni për ndryshime relevante.

Emri: _____


Nënshkrimi: _____

Data: _____


SHTOJCA 3

Skemat e mëposhtme janë vetëm për efekt ilustrues dhe nuk paraqesin të gjitha situatat reale të mundshme dhe as nuk mund të përdoren për të interpretuar të drejtat dhe detyrimet e palëve në funksion të kësaj rregulloreje.


Lidhje standarte




Lidhje standarte (e përbashkët)




Lidhje e forcuar




Lidhje e forcuar (e perbashket)



Modifikim standard



Modifikim i perforcuar



MARRËVESHJA E OPERIMIT
NË RRJETIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT OST SHA DHE PËRDORUESIT

— . — . — .

KJO MARRËVESHJE E OPERIMIT (Marrëveshja) lidhet sot më datë _____.20____, ndërmjet:

1. Operatorit të Sistemit të Transmetimit (më poshtë referuar si OST sh.a.), shoqëri aksionare e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31935, datë 14.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, _____, me NIPT K42101801N, përfaqësuar nga z. _____, **administratori i OST sh.a.**,

dhe

2. Shoqërisë _____, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar si person juridik me vendimin nr. _____, datë _____, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me NIPT _____, me seli të regjistruar në adresën: _____, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z./znj. _____ (këtu me poshtë referuar si **“Përdoruesi”**),

secila referuar sipas marrëveshjes, gjithashtu, si **“Pala”** ose së bashku **“Palët”**, sipas rastit.

Meqenëse:

A. Bazuar në marrëveshjen e lidhjes midis OST sh.a. dhe shoqërisë _____, nr. _____ prot., datë _____._____, u dha leja për lidhje HEC/ngarkesën, me fuqi totale të instaluar _____mw, pranë _____, nëpërmjet asetëve të lidhjes me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, sipas skemës principale elektrike të lidhjes së aprovuar së bashku me dokumentacionin teknik shtesë;

B. Në zbatim të parashikimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, palët do të hyjnë në marrëveshje për operimin e (*përshkrim i shkurtyr i karakteristikave të Përdoruesit*) me rrjetin e transmetimit, sipas skemës principale elektrike të aprovuar.

Palët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Aneksat dhe përkufizimet

1. Të gjitha parashikimet dhe aneksat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

2. Me anekse do të kuptojmë:

- a) Aneksi nr. 1. Parametrat operacionalë;
- b) Aneksi nr. 2. Personeli operativ i autorizuar;
- c) Aneksi nr. 3. Plani i mbrojtjes dhe rivendosjes;
- d) Aneksi nr. 4. Dokumentacionin teknik final;
- e) Aneksi nr. 5. Pyetësi i monitorimit.

Në rast konflikti, ndërmjet përcaktimeve të bëra në aneksat e kësaj kontrate dhe dispozitave të mëposhtme, këto të fundit do të mbizotërojnë.

3. Në këtë marrëveshje (përfshirë aneksat e saj), përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, çdo term dhe përkufizim i përdorur ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Marrëveshjen e Lidhjes.

Neni 2

Objekti

Kjo marrëveshje ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet midis OST sh.a. dhe Përdoruesit të rrjetit në lidhje me tërësinë e veprimeve operative të detyrueshme që do të kryejë Përdoruesi i rrjetit, i lidhur në sistemin e transmetimit si rezultat i kësaj lidhjeje dhe në funksion të kryerjes së operimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të energjisë elektrike.

Neni 3

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar, përveç rasteve të mospërmblidhjes, sipas nenit 18.

2. Në rastin kur Përdoruesi synon ta përfundojë këtë marrëveshje duhet të bëjë të ditur qëllimin për përfundimin e saj, duke njoftuar OST sh.a. me anë të njoftimit të regjistruar 3 (tre) muaj përpara.

Neni 4
Detyrimet e OST sh.a.

OST sh.a. do të koordinojë dhe do të operojë Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe kësaj marrëveshjeje, duke marrë përsipër planifikimet dhe detyrimet përkatëse ndaj Përdoruesit.

Neni 5
Kushtet e operimit

1. Përdoruesi do të zbatojë dhe do të respektojë kushtet e operimit që përcaktojnë veprimet e përbashkëta operative që kryhen në gjendjen normale të operimit të sistemit, si dhe veprimet e përbashkëta në kushte jonormale, nëse sistemi është në gjendje:

- a) Alarmi;
- b) Emergjence;
- c) Rënie të pjesshme/rënie të plotë;
- d) Rivendosje.

2. Përdoruesi respekton dhe zbaton procedurën e komunikimit me OST sh.a., siç përshkruhet në këtë marrëveshje dhe në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

3. Përdoruesi respekton kufijtë dhe parametrat e sigurisë operationale të përcaktuar në këtë marrëveshje në aneksin 1, në lidhje me:

- a) Menaxhimin e tensionit dhe të fuqisë reaktive;
- b) Menaxhimin e frekuencës;
- c) Menaxhimin e rrymave të lidhjes së shkurtër;
- d) Faktorin e fuqisë;
- e) Tokëzimin;
- f) Vlerat e shkyçjes automatike nga mbi/ nënfrekuenca.

Neni 6
Operimi dhe detyrimet e Përdoruesit

1. Përdoruesi do të përfitojë shërbimin e transmetimit nga OST sh.a., në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

2. Përdoruesi do të operojë pajisjet e tij në përputhje me specifikimet teknike të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe kërkesat e OST sh.a., me kujdesin e duhur për sigurinë operationale të rrjetit dhe të përdoruesve të tjerë.

3. Në çdo rast, përdoruesi (Qendra Operative e Përdoruesit) do të veprojë sipas urdhrave apo udhëzimeve të OST sh.a. (Qendra Kombëtare Dispeçer) dhe çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet sipas procedurave të parashikuara në aktet në fuqi, pas kapërcimit të situatës së emergjencës dhe normalizimit të gjendjes së sistemit.

4. Përdoruesi mban objektin (njësinë e tij të gjenerimit/të konsumit të energjisë) në gjendje operimi të sigurt, të qëndrueshëm, eficient dhe në pajtueshmëri, në përputhje me marrëveshjen e lidhjes dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit gjatë gjithë jetëgjatësisë së tij.

5. OST sh.a. ka të drejtë të ketë akses në të dhënat dhe dokumentacionin e Përdoruesit, duke respektuar konfidencialitetin e tyre dhe duke siguruar mospublikimin e informacionit me natyrë tregtare, konform përcaktimeve të bëra në Kodin e Rrjetit të Transmetimit për Konfidencialitetin.

6. OST sh.a. ka të drejtë të kryejë monitorimet (sipas aneksit 5), inspektimet dhe testimet e nevojshme dhe të kërkojë nga Përdoruesi kryerjen e testeve, konform Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

7. Përdoruesi bashkëpunon dhe koordinon me OST sh.a., duke zbatuar instruksionet dhe urdhrat, të cilët lidhen me operimin eficient dhe të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik, sigurinë operationale dhe të furnizimit në nivel kombëtar dhe në raport me sistemet fqinje.

8. Përdoruesi duhet të njoftojë menjëherë OST sh.a., në lidhje me çfarëdo çrregullimi operational të objekteve të tij ose në pamundësi të operimit, të cilat mund të kenë ndikim në pajtueshmërinë e tij me kërkesat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

9. Përdoruesi që dështon në zbatimin e ndonjë dispozite të Kodit të Rrjetit të Transmetimit do të informojë menjëherë OST sh.a. për arsyet e dështimit.

10. Përdoruesi është përgjegjës për trajnimin dhe certifikimin e operatorëve të tij për kryerjen e veprimeve operative, siç përcaktohen në Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe në këtë marrëveshje. Stafit operativ i tij duhet që të jetë në gjendje të kryejë çdo veprim operativ të kërkuar nga operatorët e Qendrës Kombëtare Dispeçer, sipas udhëzimeve të saj, pa rrezikuar sigurinë e sistemit, rrjetit, pajisjeve, makinerive ose jetën e njerëzve. Minimalisht, personeli operativ i Përdoruesit duhet të jetë i pajisur me grupin III në dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik, bazuar në rregulloren e sigurimit teknik (sipas kapitullit I, pikat 1–12, kapitullit II, pika 2-2).

11. Përdoruesi do të operojë pajisjet e tij për të injektuar/për të marrë energji elektrike në/nga rrjeti i transmetimit, në përputhje me fuqinë e instaluar të deklaruar në pikën e lidhjes, sipas aneksit 4 të kësaj marrëveshjeje.

12. Përdoruesi do t'i krijojë të gjitha lehtësirat e nevojshme OST sh.a. në kryerjen e funksioneve të mirëmbajtjes, të përmirësimit dhe të zgjerimit të sistemit të transmetimit, duke zbatuar udhëzimet e OST sh.a., në përputhje me parashikimet e marrëveshjes së lidhjes.

13. Përdoruesi nuk do të shkaktojë vonesa pa arsye ose pengojë dhe kufizojë OST sh.a. në kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, të cilat janë të nevojshme për sigurinë dhe operimin e rrjetit të transmetimit apo që janë pjesë e planeve të zhvillimit apo investimit në asetet e OST sh.a.

14. Përdoruesi do të bëjë përpjekjet e mundshme për të siguruar koordinimin e programeve të mirëmbajtjes dhe të stakimeve që lidhen me to, në mënyrë që të mos cenohen interesat legjitimë të të gjithë përdoruesve të rrjetit.

Neni 7

Ushtrimi i të drejtave

1. Përdoruesi bie dakord se OST sh.a. do të veprojë në zbatim të detyrimeve të saj dhe në funksion të shërbimit publik, përfshirë dhe de-energizimin e Përdoruesit, nëse masat e tjera të disponueshme rezultojnë joefektive, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

2. Në çdo rast, marrja e masave nga OST sh.a. do të jetë e përshkallëzuar dhe proporcionale me situatën, duke informuar Përdoruesin për çdo hap dhe pasojë, duke i dhënë mundësi Përdoruesit për të marrë masat e nevojshme apo eliminuar shkeljet e mundshme dhe duke bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për zgjidhje.

3. Në çdo rast, OST sh.a. do të informojë Përdoruesin para de-energizimit, përveçse në rastet e emergjencës/avarisë, kur njoftimi jepet pas de-energizimit.

Neni 8

Dispeçerimi

1. OST sh.a. është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë elektrike dhe përdorimin e linjave të interkoneksionit, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Rregullat e Tregut dhe rregulloret e tjera në fuqi, të miratuara nga ERE, duke garantuar sigurinë e operimit të rrjetit të transmetimit.

2. Dispeçerimi i instalimeve të Përdoruesit bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

3. OST sh.a. merr masa për të garantuar sigurinë e operimit të sistemit elektroenergjetik dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike të përdoruesve të rrjetit, ndërsa Përdoruesi zbaton urdhrat dhe kërkesat e OST sh.a. në lidhje me masat e marra.

4. Gjatë implementimit të masave përmirësuese ose të një mase të planit të mbrojtjes, stafi operativ i Përdoruesit duhet të ekzekutojë, pa vonesë urdhrat dhe instruksionet e dhëna nga OST sh.a. për të ruajtur sigurinë operative të sistemit të transmetimit.

5. Përdoruesi është përgjegjës për kryerjen e veprimeve operative në koordinim me Qendrën Kombëtare Dispeçer.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e Qendrës Kombëtare Dispeçer dhe Qendrës Operative të Përdoruesit

1. Qendra Kombëtare Dispeçer (QKD) e OST sh.a. do të dispeçerojë të gjithë n/st. 220, 110 kV që janë pronë e Përdoruesit të lidhur në rrjetin e transmetimit, duke udhëzuar sipas nevojës regjimin e punës në objektet e Përdoruesit në rastet e emergjencës.

2. Çdo manovrim nga ana e personelit operativ të këtyre n/st. lidhur me hapjen, mbylljen manovrimin,

tokëzimin, operimin e linjave, zbarave, çelësive, thikave etj., do të kryhet vetëm me urdhër të Qendrës Kombëtare Dispeçer, sipas procedurës së koordinimit të veprimeve operative të përshkruara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

3. Të gjitha veprimet që lidhen me objektet e përdoruesve me pikë lidhjeje në rrjetin e transmetimit, do të kryhen me koordinimin e Qendrës Kombëtare Dispeçer. Hierarkia operative për çdo urdhër do të jetë: Qendra Kombëtare Dispeçer, Qendra Operative e Përdoruesit, n/st. respektiv.

4. Për çdo stakim në gjendje avarie, Qendra Operative e Përdoruesit është e detyruar të njoftojë menjëherë Qendrën Kombëtare Dispeçer, ku minimalisht do të raportohet:

- a) Elementi i stakuar nga veprimi mbrojtës;
- b) Tipi i mbrojtjes që ka vepruar, duke stakuar elementet e Përdoruesit apo të rrjetit të transmetimit;
- c) Lokalizatori (distanca);
- d) Koha ekzakte e veprimit të mbrojtjes;
- e) Pozicionet e çelësive të linjës/të transfor-matorëve;
- f) Pozicionet e thikave të punës/të tokëzimit;
- g) Shkaku që solli gjendjen e avarisë;
- h) Të dhëna të tjera në varësi të tipit të mbrojtjes.

5. Pas eliminimit të gjendjes së avarisë, Përdoruesi duhet të dërgojë me postë elektronike pranë OST sh.a. brenda ditës, informacion të detajuar mbi avarinë, duke raportuar shkahun, dinamikën, masat e marra për eliminimin e avarisë.

6. Qendra Kombëtare Dispeçer e OST sh.a. dhe Qendra Operative e Përdoruesit janë të detyruara të kenë shkëmbim reciprok informacioni, për sa u përket parametrave: rrymë, tension, frekuencë, fuqi, përfshirë gjendjen e elementeve në n/st. dhe çdo parametër tjetër që OST sh.a. e vlerëson të nevojshëm për funksionet e saj, në kohë reale, sipas Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

7. Qendra Operative e Përdoruesit kryen me saktësi veprimin dhe operimin e pajisjes pasi sigurohet që ka kuptuar dhe përsëritur urdhrin/ veprimin operativ që duhet kryer, instruksionet dhe udhëzimet e operatorit të Qendrës Kombëtare Dispeçer, duke zbatuar me rigorozitet, në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik dhe të shfrytëzimit të pajisjeve dhe makinerive.

Neni 10

Koordinimi i veprimeve operative të Qendrës Kombëtare Dispeçer dhe Qendrës Operative të Përdoruesit

1. Koordinimi i veprimeve operative ndërmjet palëve është i nevojshëm për shkëmbimin e informacionit në lidhje me veprimet operative dhe/ ose ngjarjet në të gjithë sistemin elektroenergjetik, që kanë ndikim në funksionimin e:

- a) Sistemit të transmetimit, në rast se veprimet operative dhe/ose ngjarja ndodhin në objektin e Përdoruesit;
- b) Objektin e Përdoruesit, në rast se veprimet operative dhe/ose ngjarja ndodhin në sistemin e transmetimit.

2. Njoftimet e Qendrës Kombëtare Dispeçer të OST sh.a. dhe Qendrës Operative të Përdoruesit bëhen si më poshtë, nga:

a) Qendra Kombëtare Dispeçer e OST sh.a., në rast se ndonjë veprim operativ ose ngjarje e paplanifikuar në sistemin e transmetimit mund të ketë ndikim në punën e objektit të Përdoruesit. Qendra Kombëtare Dispeçer njofton Qendrën Operative të Përdoruesit, nëse në gjykimin e Qendrës Kombëtare Dispeçer veprimi ka ndikim sipas përcaktimeve të këtij paragrafi.

b) Qendra Operative e Përdoruesit, në rast se ndonjë veprimi operativ ose ngjarjeje të paplanifikuar në objektin e Përdoruesit mund të ketë ndikim në punën e sistemit të transmetimit. Qendra Operative e Përdoruesit njofton Qendrën Kombëtare Dispeçer të OST sh.a., e cila nga ana e saj fillon marrjen e masave përmirësuese dhe njofton Përdoruesit e tjerë të rrjetit të transmetimit, nëse në gjykimin e Qendrës Kombëtare Dispeçer veprimi ka ndikim sipas specifikimeve të këtij paragrafi.

3. Njoftimi për veprimet operative duhet të përmbajë qëllimin dhe detajet e mjaftueshme për të përshkruar veprimin operativ.

4. Kërkohej një njoftim i një veprimi operativ kur/dhe ndikimet e këtij veprimi operativ janë si më poshtë:

- a) Impianti dhe/ose aparaturat janë duke funksionuar jashtë mundësive të tyre ose mund të paraqesin rrezik për personelin;

- b) Stakim të impiantit dhe/ose aparaturave, manuale ose automatike;
- c) Nivelet e tensionit janë jashtë standardeve;
- d) Nivelet e frekuencës janë jashtë standardeve;
- e) Luhatjet e ngarkesës;
- f) Aktivizimi i ndonjë alarmi ose treguesi të ndonjë kushti funksionimi jonormal;
- g) Nëse nga eksperiencia vihen re ose parashikohet kalimi në gjendje avarie, defekte në pajisjet e monitorimit, të kontrollit, të komunikimit ose të matjes; rritja e rreziqeve të veprimeve të mbrojtjes rele; mosfunksionimi i pajisjeve komutuese; rrezik zjarri etj.

5. Kërkesat për raportimin me shkrim të ngjarjeve, të cilat fillimisht ishin raportuar verbalisht ose me postë elektronike, midis Qendrës Kombëtare Dispeçer dhe Qendrës Operative të Përdoruesit bëhen në rast se:

- a) Ngjarja mund të pasohet me incident, në rastin kur ndikimi i ngjarjes mbi sistemin e transmetimit apo mbi sistemin e Përdoruesit është me pasoja jo të dëshirueshme.
- b) Ngjarjet që ndodhin në objektin e Përdoruesit të rrjetit raportohen në Qendrën Kombëtare Dispeçer dhe te përdoruesit e tjerë të ndikuar.
- c) Ngjarjet të cilat ndodhin në sistemin e transmetimit raportohen nga Qendra Kombëtare Dispeçer te Përdoruesit e tjerë të ndikuar, të lidhur në rrjetin e transmetimit.

6. Ngjarjet me incident që duhen raportuar, rrugët e raportimit që do të ndiqen dhe informacioni që do të jepet, detajohen si më poshtë:

- a) Luhatje të parametrave operacionale (sipas aneksit 1);
- b) Defekte me rrezik në pajisjet kryesore, si: linja, transformatorë, pajisje komutimi, zbara;
- c) Ngjarje me incident me rënie zjarri;
- d) Shkelje e standardeve të sigurisë dhe rregullave të sigurimit teknik etj.

7. Të gjitha ngjarjet që shoqërohen me incident në sistemin e transmetimit dhe/ose sistemin/ objektin e Përdoruesit, raportohen. Raportimi operativ bëhet gjithmonë midis stafit operativ të Qendrës Kombëtare Dispeçer dhe stafit operativ të Përdoruesit në kohën që ndodh ngjarja. Këto raporte dokumentohen në librat e shënimeve operative.

8. Ngjarja me incident raportohet nga Përdoruesit në OST sh.a., sipas afateve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, me një informacion të hollësishëm mbi shkaqet e incidentit, ngjarjen dhe pasojat pas ngjarjes.

9. Nëse ngjarja shoqërohet me aksidente, raportimi i aksidentit bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Ky raportim bëhet në të dyja rastet:

- a) Kur aksidenti është fatal;
- b) Kur aksidenti është jofatal por me dëmtime serioze.

Raporti dërgohet edhe në inspektoratin ose organet përkatëse, konform legjislacionit në fuqi.

10. Planifikimi i ndërprerjeve në sistemin e transmetimit do të bëhet sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

11. Përdoruesi, në rastin e rënies së pjesshme apo të plotë të sistemit, duhet zbatojë të gjithë urdhrat operativë të Qendrës Kombëtare Dispeçer të OST sh.a., në përputhje me planin e rivendosjes të OST-së.

12. Risinkronizimi i Përdoruesit bëhet vetëm pas urdhrat të dhënë nga operatori i Qendrës Kombëtare Dispeçer për sinkronizim.

Neni 11

Struktura organizative e Qendrës Operative të Përdoruesit dhe stafi operativ

1. Përdoruesi i sistemit të transmetimit, brenda strukturës së tij organizative përcakton qartë organizimin dhe përbërjen e strukturës që do të luajë rolin e Qendrës Operative të cilën ia komunikon OST sh.a. Sipas rastit, Përdoruesi ia cakton këtë rol:

- a) Personelit të nënstacionit;
- b) Personelit të shërbimit operativ në instalimet dhe objektet e Përdoruesit.

2. Para energjizimit të lidhjes, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së lidhjes, Përdoruesi dorëzon kopje të dokumentit të certifikimit të personelit operativ të Përdoruesit nga prodhuesi dhe/ose assembluesi i makinerive dhe i pajisjeve (n/st., HEC) apo çdo subjekt tjetër me autoritet për trajnim dhe certifikim, që dëshmon aftësinë e personelit operativ të Përdoruesit për operimin e sistemit të Përdoruesit. Përdoruesi duhet të garantojë dhe të sigurojë që personeli i tij operativ t'i nënshtrohet testimit vjetor, në lidhje me rregullat e sigurimit teknik dhe i paraqet rezultatet e tij në OST sh.a.

3. Përdoruesi dhe OST sh.a. shkëmbejnë informacionin në lidhje me personelin operativ të autorizuar,

sipas aneksit 2 dhe e përditësojnë sipas atë nevojës.

4. Përveç parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, personeli i Qendrës Operative të Përdoruesit do të marrë pjesë në sesione instruktimi periodike të organizuara nga Qendra Kombëtare Dispeçer mbi standardet e operimit dhe kryerjen e veprimeve operative, si Përdoruesi i rrjetit të transmetimit, të cilat do të organizohen sipas programeve vjetore të miratuara nga OST sh.a.

Neni 12

Menaxhimi dhe operimi i nënstacionit

1. Nënstacioni do të menaxhohet dhe do të operohet nga Përdoruesi, me personelin e vet, me kualifikim të përshtatshëm, sipas nenit 11 dhe legjislacionit përkatës.

2. Përdoruesi do të fillojë aktivitetin e shërbimit të nënstacionit, i pavarur me personelin e vet, vetëm pasi të jenë kompletuar me sukses procedurat e testimit, komisionimit dhe energjizimit, sipas marrëveshjes së lidhjes dhe marrëveshjes së operimit.

Neni 13

Plani i mbrojtjes dhe rivendosjes

1. Në rastin e rënies së plotë ose të pjesshme të sistemit, OST sh.a. zbaton procedurat përkatëse të drejtimit operativ që sjellin frekuencën, tensionin dhe parametra të tjerë operacionalë brenda limiteve të lejuara të sigurisë operative, sipas “Planit të mbrojtjes dhe rivendosjes”, i cili rishikohet dhe përditësohet nga OST sh.a., në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

2. Përdoruesi merr masa për implementimin e “Planit të mbrojtjes dhe rivendosjes”, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Marrëveshjes së operimit dhe udhëzimeve të OST sh.a.

3. Sipas nevojës, Përdoruesi duhet të jetë i aftë për të zbatuar procedurat përkatëse dhe u bindet urdhrave operativë për kufizimet/reduktimet manuale të ngarkesës duke iu përgjigjur emergjencave në kohë reale.

4. Përdoruesi respekton urdhrat e OST sh.a. për vlerat e lejuara të mbingarkesës së linjave për sezonin dimër-verë dhe kohën e punës në mbingarkesë për çdo element, si dhe respekton dhe zbaton urdhrat e OST sh.a. për ndryshimin e regjimit dhe/apo skemave, të cilat kërkojnë veprime me asetet e tij të lidhjes apo objektin e tij.

5. Përdoruesi, në rastin e rënies së plotë/të pjesshme të sistemit dhe të humbjes së komunikimit me Qendrën Kombëtare Dispeçer, vetëvepron duke stakuar çelësat e transformatorëve të fuqisë dhe siguron nevojat vetjake nga gjeneratorët diezel. Me rivendosjen e komunikimit me Qendrën Kombëtare Dispeçer, ndjek udhëzimet për veprimet e mëtejshme operative.

6. Përdoruesit do të marrin masa për ruajtjen dhe paraqitjen e dokumentacionit dhe të dhënave të nevojshme për përmbushjen e planit të mbrojtjes dhe rivendosjes, duke mbledhur të dhëna dinamike për ngarkesat/gjenerimin e tyre, në formatin e përcaktuar nga OST sh.a. dhe duke i paraqitur sipas afateve apo kërkesës së OST sh.a.

7. Plani i mbrojtjes dhe i rivendosjes, pjesë e kësaj marrëveshjeje, sipas aneksit 3, hartohet dhe përditësohet nga OST sh.a. dhe u jepet përdoruesve për njohje dhe zbatim.

Neni 14

Planifikimi i ndërprerjeve dhe de-energizimi

1. OST sh.a. dhe Përdoruesi duhet, në atë masë që është praktikisht e mundur dhe e arsyeshme, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, të koordinojnë ndërprerjet e planifikuara në rrjet dhe në asetet e lidhjes.

2. OST sh.a. dhe Përdoruesi do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që ndërprerjet e tilla do të jenë me kohëzgjatje minimale dhe do të shkaktojnë shqetësime minimale për të tretët dhe nuk do të dëmtojnë funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të sistemit.

3. Pavarësisht nga planifikimi vjetor i ndërprerjeve, OST sh.a. do të mund të kryejë ndërprerje të programuara, të detyruara dhe de-energizim të pikës së lidhjes së Përdoruesit, kur kjo kërkohet, me qëllim ushtrimin e funksioneve të saj, me qëllim përmirësimin e kushteve të operimit të rrjetit për Përdoruesit e rrjetit, me kushtin që të njoftojë këtë të fundit 7 (shtatë) ditë përpara ditës së kryerjes së ndërprerjeve, për ndryshimin e planit të ndërprerjeve dhe për kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruar sipas rastit.

4. Njoftimi i OST sh.a. do të përfshijë:

a) Njoftimin dhe arsyetimin;

b) Planin e ndërprerjeve të përditësuar;

c) Ndërprerjen e programuar të detyruar, duke specifikuar numrin e pritshëm të ndërprerjeve, kohëzgjatjen në orë dhe datat për secilën pikë lidhjeje ku kryhet ndërprerja.

5. Nëse Përdoruesi pengon OST sh.a. në kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruara, bëhet përgjegjës për të gjitha pasojat dhe kostot që lidhen me vonesat dhe që mund t'i shkaktohen OST sh.a. apo të tretëve, me të cilët OST sh.a. është në marrëdhënie kontraktuale.

6. OST sh.a. do të ushtrojë të drejtën e de-energizimit të Përdoruesit në çdo kohë dhe në afatet dhe masën që OST sh.a. e vlerëson proporcionale me situatën, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit ose në ndonjë nga rrethanat e mëposhtme:

a) Në kushtet e forcës madhore, kur konsiderohet se rrethanat e kërkojnë një masë të tillë; dhe/ose
b) Për qëllim të realizimit të projekteve për fuqizimin e rrjetit të transmetimit; dhe/ose
c) Për qëllim të realizimit të lidhjeve të reja të të tretëve në rrjetin e transmetimit; dhe/ose
d) Me qëllim gjetjen dhe eliminimin e një defekti dhe/ose mirëmbajtjen, dhe/ose riparimin, dhe/ose zëvendësimin e pjesshëm ose të plotë, dhe/ose modifikimin, dhe/ose shtimin, dhe/ose testimin e një pjese të rrjetit, të cilat janë të nevojshme për të siguruar funksionimin normal dhe për të fuqizuar sigurinë operacionale të rrjetit; dhe/ose

e) Nëse është e nevojshme në një situatë emergjence në/ose në afërsi të rrjetit ose në rast nevojë për të zbutur efektet e çdo rreziku material ose humbjeje financiare për çdo person apo pronë të lidhur me ose pranë rrjetit; dhe/ose

f) Kur Përdoruesi nuk përmbush detyrimet, në bazë të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe sipas vlerësimit të OST sh.a., kjo ka një efekt material të dëmshëm në rrjet; dhe/ose

g) Në funksion të nenin 7, "Ushtrimi i të drejtave";

7. OST sh.a. do të rienergizojë sa më parë që është e mundur Përdoruesin kur ka të dhëna që rrethanat që çuan në de-energizim nuk ekzistojnë më apo ka garanci të dokumentuar që rrethanat nuk do të përsëriten;

8. Rienergizimi do të kryhet me koordinimin e të dyja palëve, duke garantuar sigurinë e operimit të sistemit dhe duke shmangur efektet shqetësuese për të tretët.

Neni 15

Dhënia e informacionit

1. Marrëveshja e operimit hyn në fuqi pasi Përdoruesi ka dorëzuar pranë OST sh.a. të gjithë dokumentacionin teknik, sipas instalimeve në objekt, të listuar në aneksin 4.

2. Përdoruesi është i detyruar të dorëzojë protokollet e plota të kontrollit dhe testimit të pajisjeve, të kryera në prani të specialistëve të OST-së dhe të firmosura prej tyre, si dhe të dorëzojë pranë OST sh.a.:

a) Një kopje të protokolleve të pranimit (FAT&SAT) të njësive gjeneruese, rregullatorit të shpejtësisë, sistemit të eksitimit, transformatorëve të fuqisë.

b) Për qëllime studimore, modelet korrespondu-ese dinamike sipas standardeve IEEE për gjenera-torët, turbinën, rregullatorin e shpejtësisë, sistemin e eksitimit, stabilizatorin e sistemit (PSS), rregullatorin e tensionit të transformatorëve të fuqisë.

Neni 16

Shkëmbimi i informacionit në kohë reale

1. Përdoruesi gjenerues i lidhur në rrjetin e transmetimit do të sigurojë në kohë reale informacionin e mëposhtëm:

a) Pozicionin e elementeve komutues në pikën e lidhjes ose një tjetër pikë ndërveprimi të rënë dakord me OST-në;

b) Fuqinë aktive, reaktive, tensionin, rrymën në pikën e lidhjes ose një tjetër pikë ndërveprimi të rënë dakord me OST-në;

c) Fuqinë aktive dhe reaktive të rrjetit, në rast se objekti (gjenerues) ka konsum tjetër përveç atij të nevojave vetjake.

2. Përdoruesi konsumator i lidhur drejtpërdrejt me rrjetin e transmetimit, do t'i komunikojë në kohë reale OST-së informacionin e mëposhtëm:

a) Fuqinë aktive, reaktive, tensionin, rrymën në pikën e lidhjes;

b) Minimumin dhe maksimumin e fuqisë që do të mund të kufizohet.

3. Informacioni i mësipërm dhe çdo parametër tjetër i kërkuar nga OST-ja do të sigurohet nëpërmjet lidhjes me sistemin SCADA.

Forca madhore

1. Me përjashtim të rasteve shprehimisht të parashikuara në këtë Marrëveshje, asnjë Palë nuk do të konsiderohet në shkelje të kësaj Marrëveshjeje, në qoftë se provon që moszbatimi i detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje është i shkaktuar nga një rast force madhore. Forca madhore është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si: tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, thatësira e tejzgatur, prurja me plota të mëdha, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë palët të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre dhe palët nuk janë në gjendje t'i eliminojnë ato edhe pse kanë ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tyre.

2. Në qoftë se çdo palë është në pamundësi të përmbushë ndonjë ose të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje për shkak të një ngjarje të forcës madhore, kjo marrëveshje do të jetë në fuqi, por:

a) Detyrimet përkatëse të palës mospërmbushëse do të pezullohen për një periudhë të barabartë me ngjarjen ose rrethanën e forcës madhore;

b) Detyrimet e Palës tjetër që i detyrohet palës mospërmbushëse sipas kësaj marrëveshjeje, të cilat pala tjetër është e pamundur t'i përmbushë drejtpërdrejt, si rezultat i pezullimit të detyrimeve të palës mospërmbushëse, do të pezullohen për një periudhë të barabartë me ngjarjen ose rrethanat e forcës madhore, duke pranuar që:

i) Pezullimi i përmbushjes është i një qëllimi jo më të madh dhe i një kohëzgjatjeje jo më të madhe se sa kërkohet për forcën madhore;

ii) Asnjë detyrim i secilës palë, i lindur përpara forcës madhore, duke shkaktuar pezullimin e përmbushjes nuk do të anashkalohet si rezultat i forcës madhore;

iii) Pala në mospërmbushje njofton menjëherë palën tjetër për ngjarjen ose rrethanën e forcës madhore, duke përfshirë natyrën dhe kohëzgjatjen e pritshme, si dhe vazhdon t'i raportojë rregullisht në lidhje me to gjatë periudhës së forcës madhore;

iv) Pala mospërmbushëse përdor të gjitha mundësitë e arsyeshme për të parandaluar, për të shmangur ose për të zbutur pasojat e forcës;

v) Menjëherë pas shfaqjes së ngjarjes ose rrethanave të forcës madhore, Palët do të diskutojnë për të vazhduar veprimet e tyre, sa më mirë dhe sa më gjatë të jetë e mundur, në përputhje me këtë marrëveshje dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

Rastet e mospërmbushjes

1. Nëse konstatohet së Përdoruesi është në shkelje/mospërmbushje të ndonjë prej dispozitave të marrëveshjes, Kodit të Rrjetit të Transmetimit apo kuadrit ligjor për sektorin e energjisë elektrike, atëherë OST-ja, në përputhje me kompetencat e saj, sa më shpejt që është e mundur, do të njoftojë Përdoruesin duke udhëzuar atë për eliminimin e tyre dhe duke përcaktuar afatet përkatëse për këtë qëllim.

2. Në vijim të njoftimit nga OST-ja dhe zbatimit të udhëzimeve për eliminimin e shkeljes/e mospërmbushjes nga ana e Përdoruesit, Përdoruesi do të njoftojë OST-në brenda afatit të caktuar në udhëzimet e dhëna prej saj ose brenda 5 ditëve pune nëse OST-ja nuk ka specifikuar afat tjetër, për hapat e ndërmarrë për eliminimin e shkeljes ose eliminimin përfundimtar të saj ose paaftësinë për të eliminuar shkeljen.

3. Nëse Përdoruesi nuk vepron në përputhje me udhëzimin e OST-së, standardet e sigurisë, Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Marrëveshjen e Lidhjes dhe Operimit, OST-ja do të japë një njoftim të dytë paralajmërues me shkrim dhe do të procedojë me de-energizimin, pas kalimit të së paku 7 (shtatë) ditëve nga ky njoftim, me kusht që në kohën e skadimit të njoftimit, Përdoruesi ende nuk ka vepruar në përputhje me udhëzimet e OST-së.

4. Përveç sa më sipër, në rast se Përdoruesi nuk përmbush detyrimet e tij sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, kur OST-ja e vlerëson të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj, ka të drejtë të de-energizojë menjëherë nënstacionin dhe të njoftojë me shkrim Përdoruesin për shkaqet e këtij de-energizimi. Përdoruesi në këtë rast do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara OST-së dhe do të marrë masat për korrigjimin e situatës dhe/ose përmbushjen e detyrimeve të saj, sa më shpejt të jetë e mundur. De-energizimi do të vazhdojë deri sa Përdoruesi të korrigjojë situatën dhe/ose të përmbushë detyrimet e tij.

Neni 19

Konfidencialiteti

1. Secila nga Palët merr përsipër që të ruajë sekret përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje dhe kushtet e saj, si dhe çdo informacion dhe/ose dokument që palët kanë shkëmbyer ose kanë marrë dijeni gjatë lidhjes dhe zbatimit të kësaj marrëveshjeje, sipas parashikimit të bërë në Kodin e Transmetimit dhe ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me përjashtim të rasteve kur bërja publike e sa më sipër është kërkesë e ligjeve shqiptare.

2. Detyrimi për të ruajtur sekret informacionet e marra si më sipër për secilën nga palët në këtë marrëveshje vazhdon edhe pas zgjidhjes së saj.

Neni 20

Njoftimet

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në nenet e tjera të kësaj marrëveshjeje, çdo komunikim sipas saj do të bëhet me shkrim dhe do të njoftohet me letër rekomande (njoftim marrjeje), por paraprakisht do të komunikohet nëpërmjet postës elektronike ose faksit, në adresat e përcaktuara më poshtë:

Për OST sh.a., në:

Adresa: OST sh.a.

Adresa postare:

Numri i faksit:

Adresa e postës elektronike:

Në vëmendje të administratorit të OST sh.a.

Për Përdoruesin, në:

Adresa:

Adresa postare:

Numri i faksit:

Adresa e postës elektronike:

Në vëmendje të përfaqësuesit ligjor të Përdoruesit:

ose në adresën dhe/ose numrin e faksit që u komunikohet palëve sipas mënyrës së përcaktuar më sipër.

2. Çdo komunikim i drejtuar në adresat e mësipërme dhe i kryer sipas mënyrës sa më sipër përcaktuar është i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët. Komunikimet konsiderohen të kryera në mënyrë të vlefshme në momentin e marrjes së letrës rekomande nga marrësi sipas mënyrës së përcaktuar më sipër.

Neni 21

Ndryshimet

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje miratohet me vendim të bordit të ERE-s.

Neni 22

Ndashmëria

1. Çdo nen, dispozitë, seksion, paragraf apo nënndarje e kësaj marrëveshjeje që është ose do të shpallet i pavlefshëm ose i paefektshëm, do të hiqet nga kjo marrëveshje, nuk do të zbatohet dhe nuk do të ndikojë, në asnjë mënyrë, në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje, për aq sa lejohet nga dispozitat ligjore.

Neni 23

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me të.

2. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në dispozitat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit. Në çdo rast tjetër, palët do të mundohen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim midis tyre dhe kur kjo është e pamundur, mosmarrëveshjet, kur nuk u nënshtrohen dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24

Gjuha

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje, të gjitha njoftimet, dokumentet, certifikatat ose dokumente të tjera që njëra nga palët i jep palës tjetër sipas kësaj marrëveshjeje, do të jenë në gjuhën shqipe.

2. Kjo marrëveshje është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, nga dy për secilën palë.

OST sh.a.

Nga: Z.

Titulli: Administrator i OST sh.a.

Përdoruesi

Nga: Z.

Titulli: Përfaqësues ligjor i Përdoruesit

ANEKSI 1
PARAMETRAT OPERACIONALË

1. Nivelet e tensionit nominal të lejuar, maksimal dhe minimal për regjimin normal të punës së rrjetit të Sistemit të Transmetimit, si dhe pas një kontigjence të listuar në listën e kontigjencave në analizat e sigurisë së Sistemit të Transmetimit.

Tensioni nominal i rrjetit (kV)	Niveli maksimal i lejuar kV (p.u.)	Niveli minimal i lejuar kV (p.u.)
220 kV	245 kV (1.118)	198 kV (0.9)
150 kV	168 kV (1.118)	135 kV (0.9)
110 kV	123 kV (1.118)	99 kV (0.9)

2. Kufijtë e lejuar të tensionit në amplitudë dhe në fazë janë:

a) Për rrjetat me tension nominal 400 kV dhe 220 kV: 2% të tensionit nominal dhe këndit të sfazimit 120°.

b) Për rrjetat me tension nominal 150 kV dhe 110 kV: 3% të tensionit nominal dhe këndit të sfazimit 120°.

3. Për tensionet nominale të rrjetit të sistemit të transmetimit 110 kV–400 kV, deformimi total harmonik duhet të jetë deri 2%.

4. Faktori minimal i lejuar i faktorit të fuqisë për Përdoruesit (ngarkesë) është 0.9 ($\cos\phi = 0.9$).

5. Koha minimale kritike e shkyçjes së defektit (koha kritike e pastrimit të defektit në sistemin elektroenergetik).

Niveli i tensionit të rrjetit kV	Koha e veprimit të mbrojtjes rele + kohën e shkyçjes së çelësit të fuqisë
220 kV	110 msec
150 kV, 110 kV	120 msec

6. Statusi i tokëzimit dhe madhësia e rezistencës së tokëzimit (plotësohet sipas projektit). Njësitë gjeneruese duhet të kenë pëshënjë të satorit të lidhur në yll dhe të gatshme për tokëzim. Faktori i lidhjes me tokën të jetë ≤ 1.4 . Gjeneruesit duhet të zbatojnë pa vonesë urdhrin e dhënë nga OST sh.a për statusin e tokëzimit të yllit të satorit në njësinë përkatëse gjeneruese, sa herë që ky status duhet të ndryshojë.

7. Përdoruesit (njësitë gjeneruese) do të jenë në gjendje të furnizojnë prodhimin nominal të fuqisë aktive me një vlerë të faktorit të fuqisë nga 0.85 induktiv deri në 0.95 kapacitiv.

8. Koeficienti (K_c) i lidhjes së shkurtër të njërive gjeneruese do të jetë ≥ 0.5 .

9. Mundësia e tarimit të statizmit të RASH-së të jetë nga 2 deri në 12%. Tarimi i përcaktuar nga OST-ja (plotësohet rast pas rasti).

10. Limitet e rrymës, në përputhje me limitin termik, duke përfshirë dhe mbingarkesën e lejuar tranzitore.

11. Përdoruesit gjenerues duhet të qëndrojnë të lidhur me rrjetin, të paktën brenda diapazoneve të frekuencës dhe kohës së përcaktuar si më poshtë:

a) Pa kufizim kohe në frekuencë nga 49.0 Hz–51.0 Hz;

b) Jo më pak se 30 minuta për frekuencë nga 47.5 Hz–48.5 Hz;

c) Për frekuencë nga 48.5–49 Hz të qëndrojnë të lidhur me rrjetin por jo më pak se koha për 47.5 Hz–48.5 Hz;

d) 30 minuta për frekuencë nga 51.0 Hz–51.5 Hz

12. Përdoruesit (njësi gjeneruese) duhet të mbeten të sinkronizuar në sistemin elektroenergjetik gjatë ndryshimit të nivelit të tensionit në pikën e lidhjes në sistem, nga:

- a) 0.85 p.u.–0.90 p.u., për 60 minuta;
- b) dhe për vlera të tensionit nga 1.118 p.u.–1.15 p.u., për së paku 20 minuta.

13. Përdoruesit konsumatorë nuk do të shqetësohen nga rrjeti për shkak të një shqetësimi, brenda kufijve të tensionit, si më poshtë:

- c) Pa kufizim kohe për tension nga 0.9 p.u.–1.05 p.u.;
- d) Sipas afatit të përcaktuar në bashkëpunim me OST fqinje për tension nga 1.05 p.u.–1.0875 p.u.;
- e) Për 60 minuta për tension nga 1.0875 p.u. deri 1.10 p.u.

14. Përdoruesit (njësi gjeneruese) duhet të sigurojnë rritjen/uljen e gjenerimit me jo më pak se 1.5% të fuqisë aktive nominale/për minutë, kur njësia gjeneruese është në kushte normale operimi.

ANEKSI 2 PERSONELI OPERATIV I AUTORIZUAR

Për Përdoruesin (gjenerues/konsumator), personat e kontaktit janë:

Nr.	Emri, mbiemri	Adresa, e-mail	Tel.	I certifikuar nga	Kateg. e sig. teknik

Për OST sh.a., personat e kontaktit janë:

Nr.	Emri, mbiemri	Adresa, e-mail	Tel.	Funksioni

Lista përditësohet në çdo rast kur ka ndryshime dhe konfirmohet duke u shkëmbyer çdo fillim viti para datës 15 janar, për vitin në vazhdim.

ANEKSI 3 PLANI I MBROJTJES DHE I RIVENDOSJES

ANEKSI 4 DOKUMENTACIONI TEKNIK FINAL

- a) Skema principale e n/stacionit ngritës në ____ ;
- b) Skema principale e mbrojtjes rele e trakteve dhe zbarave të TL-së;
- c) Skema principale e matjes në anën e TL-së të transformatorit/transformatorëve ngritës;
- d) Planimetria e n/stacionit ngritës;
- e) Traseja dhe planimetria e linjës;
- f) Diagrami i kontroll-monitorimit;
- g) Diagrami i sistemit SCADA dhe i telekomunikacionit;
- h) Specifikimet teknike të pajisjeve kryesore;
- i) Modelet dinamike të njësive gjeneruese;
- j) Projekt zbatimin përfundimtar;
- k) Grafiku i punimeve i detajuar.

ANEKSI 5
PYETËSORI I MONITORIMIT

MARRËVESHJA E LIDHJES ME RRJETIN E TRANSMETIMIT
NDËRMJET OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST SHA DHE
PËRDORUESIT

____.____.____

Kjo Marrëveshje e lidhjes (Marrëveshja) lidhet sot, në datën __.__.20__ ndërmjet:

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit (më poshtë referuar si OST sh.a.), shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31935, datë 14.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, _____, me NIPT K42101801N, përfaqësuar nga **z. _____, administratori i OST sh.a.,**

dhe

2. Shoqërisë _____, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar si person juridik me vendimin nr. _____, datë _____, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me NIPT _____, me seli të regjistruar në adresën: _____, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z/znj. _____ (këtu më poshtë referuar si “**Përdoruesi**”), secila referuar sipas marrëveshjes, gjithashtu, si “**Palë**” ose së bashku “**Palët**”, sipas rastit.

Meqenëse:

A. Me shkresën nr. _____ prot., datë _____, shoqëria _____ ka paraqitur në OST sh.a. kërkesën për lidhje me rrjetin e transmetimit të OST sh.a., të një _____ (HEC/ngarkesën), me fuqi _____, të vendosur në _____.

B. Me shkresën nr. _____ prot., datë _____, të OST sh.a., shoqërisë _____ iu dha oferta e lidhjes për të lidhur në rrjetin e transmetimit të OST sh.a., të _____, sipas skemës principale elektrike të lidhjes së _____, me sistemin e transmetimit të aprovuar (aneksi 1).

C. (Përshkrim i përmbledhur i skemës së lidhjes.)

D. Me shkresën nr. _____ prot., datë _____, “Deklaratë pranimi”, Shoqëria _____ ka informuar OST sh.a. për pranimin e ofertës së lidhjes së _____, nëpërmjet skemës _____ (aneksi 1).

E. OST sh.a. dhe shoqërisë i kërkohet që sipas Kodit të Rrjetit (siç përshkruhet më poshtë) të hyjë në marrëveshje për lidhjen e _____, me rrjetin e transmetimit, sipas skemës principale elektrike të aprovuar.

F. Shoqëria është pajisur/në proces për t’u pajisur me licencë për (prodhimin e energjisë elektrike/tjetër) nga ERE, miratuar me vendimin e ERE-s nr. ____, datë ____, që i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje si aneks nr. 2., me pajisjen me këtë licencë, shoqëria do të dorëzojë pranë OST-së kopje të kësaj licence që do t’i bashkëngjitet kësaj kontrate.

G. Shoqëria pranon se parashikimet e përcaktuara në këtë marrëveshje janë subjekt dhe rregullohen nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe anekset e tij, “Rregullorja e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, si dhe aktet e tjera dalë në zbatim të tyre, dhe i deklaron për të njohura dhe të pranuar pa asnjë kusht ose rezervë.

Palët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Anekset dhe përkufizimet

1. Të gjitha parashikimet dhe anekset përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

2. Me anekse do të kuptojmë:

- a) Aneksi nr. 1. Dokumentacioni teknik i lidhjes me rrjetin kombëtar të transmetimit
- b) Aneksi nr. 2. Licenca për prodhimin e energjisë elektrike, e lëshuar nga ERE
- c) Aneksi nr. 3. Specifikimet teknike të sistemit të matjes tregtare
- d) Aneksi nr. 4. Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin e telekomunikacionit
- e) Aneksinr. 5. Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare

Dispeçer

f) Aneksi nr. 6. Deklaratat e përgjegjësive dhe gatishmërisë

g) Aneksi nr. 7. Dorëzimi i pjesës së linjës

h) Në rast konflikti, ndërmjet përcaktimeve të bëra në anekset e kësaj kontrate dhe dispozitave të mëposhtme, këto të fundit do të mbizotërojnë.

3. Në këtë Marrëveshje (përfshirë anekset e saj), përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të nënkuptojnë si vijon dhe përveç këtyre përcaktimeve çdo term tjetër i përdorur në këtë marrëveshje ka të njëjtin kuptim me përkufizimet e termave të dhënë në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“**Akt**” nënkupton çdo ligj, vendim të Këshillit të Ministrave, udhëzim të ministrive ose të organeve publike rregullatore ose jo, të veshura me kompetenca për të nxjerrë akte me qëllim rregullimin e një fushe të caktuar, të cilat kanë efekt mbi veprimtarinë e palëve dhe veçanërisht mbi fushën objekt të kësaj marrëveshje.

“**Marrëveshje**” nënkupton këtë marrëveshje të lidhur midis Përdoruesit dhe OST-së me qëllim përcaktimin e kushteve për lidhjen dhe përdorimin e rrjetit kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike nga Përdoruesi.

“Përdorues” nënkupton personat fizikë ose juridikë, të cilët furnizojnë me ose të cilët furnizohen me energji elektrike nëpërmjet rrjetit të sistemit të transmetimit.

“Objekti”, impiant gjenerimi ose ngarkese.

“Hidrocentrali” [në rastin e marrëveshjeve të lidhjes me impiant gjenerimi] nënkupton, hidrocentralin _____ që do të ndërtohet nga Përdoruesi.

“Asetet e lidhjes” nënkupton asetet e lidhjes (linja, nënstacioni, elemente të tjera lidhëse) që do të ndërtohen nga Përdoruesi, për të lidhur centralin prodhues/konsumator të energjisë elektrike me rrjetin e transmetimit, siç është paraqitur në aneksin nr. 1.

“Nënstacion” nënkupton nënstacionin TL/TM që do të ndërtohet nga Përdoruesi.

“Pika e lidhjes” nënkupton pikën ku objektet lidhen me rrjetin e transmetimit, që përcakton vendin e saktë të lidhjes me rrjetin e transmetimit (hyrje-dalje në linjë, lidhje në zbara etj.)

“Pika e matjes” nënkupton pikën ku matet energjia elektrike që Përdoruesi injekton në/merr nga rrjeti i transmetimit që është i instaluar në anën e tensionit të lartë të transformatorit të fuqisë.

“Komisionim” nënkupton procesin e testimit, kontrollit dhe kolaudimit të aseteve të lidhjes (nënstacionit TL/TM dhe pjesës së linjës lidhëse), për të plotësuar kushtet dhe përcaktimet e parashtruara nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit.

“**Licenca**” nënkupton në çdo kohë, dokumentin zyrtar për licencimin e një subjekti dhe veprimtarinë e saj sipas ligjit të zbatueshëm.

“**Kodi i Rrjetit**” nënkupton Kodin e Rrjetit të Transmetimit të miratuar nga ERE, që është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E.

“**Rregullator**” nënkupton Entin Rregullator të Energjisë (ERE).

“Rrjeti i transmetimit” nënkupton rrjetin kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike siç përcaktohet në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

“Ndryshim në kontroll” nënkupton çdo shitje, kalim, transferim, ndërprerje, qira, tjetërsim,

dhurim, dorëheqje, shkëmbim ose ndonjë heqje tjetër dore nga kontrolli.

“**Punimet**” nënkupton punën që do të kryhet nga Përdoruesi ose kontraktori i tij për të realizuar lidhjen në rrjetin e transmetimit.

“Ndërprerje të programuara të detyruara” nënkupton çdo ndërprerje të detyruar nga rrethana siç përcaktohen në këtë marrëveshje, të kërkuar nga OST-ja, në përputhje me këtë marrëveshje dhe që amendon ndërprerjet e planifikuara në sistem

“**Ditë pune**” nënkupton të gjitha ditët e javës, përveç të shtunës, të dielës dhe çdo dite pushimi zyrtar në Republikën e Shqipërisë.

“Qendra Operative e Përdoruesit” nënkupton njësinë organizative të Përdoruesit me aftësitë e nevojshme teknike, e cila është ndërfaqja direkte ndërmjet objektit të Përdoruesit dhe OST/Qendrës Kombëtare Dispečer.

Neni 2 Objekti

i) Objekti i Marrëveshjes është përcaktimi i termave dhe kushteve për lidhjen në Rrjetin e Transmetimit të OST sh.a., të _____(objekti plotësohet me përshkrim përkatës), të shoqërisë _____, sipas skemës _____ (aneksi 1).

Neni 3 Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar, përveç rasteve të zgjidhjes së marrëveshjes sipas nenit 18.

2. Në rastin kur Përdoruesi synon ta përfundojë këtë Marrëveshje, duhet të bëjë të ditur qëllimin e saj, duke njoftuar OST sh.a. me anë të njoftimit të reregjistruar 3 (tre) muaj përpara.

3. Zgjidhja e Marrëveshjes sjell shkëputjen fizike të pikës së lidhjes (sipas projektit për lidhjen).

Neni 4 Deklarime dhe garanci të Përdoruesit

Përdoruesi deklaron dhe garanton OST sh.a., se:

1. Përdoruesi është themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, i regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar dhe nuk është subjekt i asnjë procedure likuidimi dhe/ose falimentimi.

2. Përdoruesi zotëron të gjitha autorizimet e nevojshme me qëllim zbatimin e punimeve që lidhen me ndërtimin, komisionimin dhe vënien në punë të objektit dhe aseteve të lidhjes.

3. Përdoruesi disponon të gjitha mjetet, financiare, teknike dhe teknologjike me qëllim realizimin e projektit që lidhet me ndërtimin e objektit, aseteve të lidhjes dhe të të gjitha veprimtarive të tjera që lidhen me mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin në punë nga vetë Përdoruesi. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e aseteve të lidhjes janë në ngarkim të shoqërisë dhe përcaktohen në marrëveshjen e mirëmbajtjes që do të lidhet midis OST sh.a. dhe shoqërisë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së operimit.

4. Përdoruesi do të zbatojë me përpikëri të gjitha procedurat dhe rregullat e zbatueshme në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe legjislacionit shqiptar në përgjithësi për ndërtimin dhe vënien në punë të objektit dhe aseteve të lidhjes.

5. Lidhja dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje nga ana e Përdoruesit nuk përbën asnjë shkelje të ligjit në fuqi në Shqipëri, dokumenteve statutorë të shoqërisë dhe çdo kontrate ose marrëveshjeje në të cilën përdoruesi është palë.

6. Shoqëria do t'i garantojë dhe do t'i sigurojë OST sh.a., përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, të drejtën e kalimit për të hyrë dhe për të kryer punime në nënstacionin lidhës me

rrjetin e transmetimit të Përdoruesit, si dhe në sipërfaqet e tokës ku kalon traseja e linjës lidhëse.

7. Shoqëria do t'i kalojë OST sh.a. në pronësi asetet e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe do t'i garantojë dhe sigurojë OST sh.a., gëzimin e qetë, për të përdorur dhe gëzuar pronën e kaluar me anë të një kontratë dhurimi. Në këtë rast, pika 3 e këtij neni nuk do të zbatohet për pjesën që lidhet me shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit të aseteve të lidhjes.

Neni 5

Deklarime dhe garanci të OST sh.a.

OST sh.a. deklaron dhe garanton Përdoruesin se:

1. OST sh.a. është një person juridik publik, i cili vepron në përputhje me legjislacionin dhe të drejtën shqiptare.

2. OST sh.a. zotëron të gjitha mjetet teknike dhe teknologjike, si dhe personelin e kualifikuar dhe të përshtatshëm me qëllim zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

3. Lidhja dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje nga ana e OST sh.a. nuk përben shkelje të ligjeve në fuqi në Shqipëri, të dokumenteve të krijimit të saj, si dhe të çdo kontrate apo marrëveshjeje ku OST sh.a. është palë.

Neni 6

Detyrimet e Përdoruesit

1. Përdoruesi ka projektuar dhe do të ndërtojë me shpenzimet e tij, objektin dhe asetet e lidhjes, që të sigurojë lidhjen e _____ (*objekti plotësohet me përshkrim sipas projektit*), me rrjetin _____ kV të transmetimit të OST sh.a.

2. Përdoruesi do të respektojë të gjitha specifikimet teknike në lidhje me telekomunikacionin, sistemin SCADA dhe matjen, pjesë të kësaj marrëveshjeje dhe të detajuara në anekset nr. 3, 4 dhe 5.

3. Përdoruesi do të përdorë për të ndërtuar asetet e lidhjes, teknologjinë bashkëkohore, si edhe të gjitha sistemet e sigurisë, në mbrojtje të rrjetit kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike.

4. Përdoruesi do të kryejë të gjitha punimet në lidhje me ndërtimin e aseteve të lidhjes, në përputhje të plotë me projektin e paraqitur dhe miratuar nga OST sh.a.

5. Përdoruesi do të lejojë në çdo moment OST sh.a., punonjësit, nënkontraktorët dhe/ose personat e tretë të autorizuar prej saj, të hyjnë në zonën në pronësi të saj ku ndodhet nënstacioni dhe linja që po ndërtohen/janë ndërtuar, me qëllim inspektimin e punimeve të kryera dhe kryerjen e verifikimeve që kërkohen në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

6. Përdoruesi garanton se me shpenzimet e tij do të ruajë të vlefshme përgjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje të gjitha autorizimet e nevojshme, me qëllim mirëfunksionimin e aseteve të lidhjes.

7. Në rast se Përdoruesi kërkon shkëputjen e lidhjes elektrike nga rrjeti i transmetimit, duhet të njoftojë OST sh.a., 3 muaj përpara dhe shoqëria është e detyruar të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për shkëputje.

8. Përdoruesi garanton se me shpenzimet e tij do të ruajë të vlefshme përgjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, të gjitha autorizimet e nevojshme me qëllim mirëfunksionimin e _____ (*objekti*) dhe aseteve të lidhjes.

9. Përdoruesi merr përsipër të mbajë në një gjendje eficiente _____ (*objekti*) që të mos shkaktojë dëmtim të Përdoruesit e tjerë, të përfshirë tashmë në rrjetin e transmetimit të OST sh.a.

10. Me kërkesë të OST sh.a. dhe në mënyrën e përcaktuar nga kjo e fundit, shoqëria, duke mbartur shpenzimet përkatëse, do të kryejë ndërhyrjet e nevojshme në _____, kur zhvillimet e rrjetit të transmetimit ose nevojat e rrjetit e bëjnë këtë të nevojshme për të garantuar sigurinë e sistemit elektroenergjetik shqiptar.

11. Shoqëria duhet të njoftojë menjëherë OST sh.a. për çdo ndryshim dhe/ose ngjarje në lidhje me karakteristikat teknike, menaxhimin, operimin dhe kontrollin e _____ (*objekti*) dhe, në përgjithësi, të respektojë detyrimet për informim në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjetit.

Neni 7

Dhënia e aksesit

1. Përdoruesi është i detyruar t'i japë akses të plotë OST sh.a. pa asnjë kundërshtim apo pretendim të çfarëdo lloji, që OST sh.a. të bëjë në të ardhmen zgjerimin e nënstacionit ngritës _____ kV, në (*plotësohet sipas rastit pika në rrjetin e transmetimit dhe detaje mbi mënyrën e zgjerimit*), për nevoja të zhvillimit të sistemit të transmetimit, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Për këtë, në sheshin e nënstacionit duhet parashikuar hapësira e lirë për zgjerimin e tij, sipas një planimetrie të aprovuar nga OST sh.a.

2. Autorizimet që do të jepen nga OST sh.a. për lidhjen e një pale të tretë nëpërmjet aseteve të lidhjes të realizuara nga shoqëria, do të jenë në respektim të nenit 28 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe "Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit".

Neni 8

Detyrime të OST sh.a.

1. OST sh.a. duhet të:

a) Marrë përsipër planifikimet dhe detyrimet përkatëse.

b) Marrë në dorëzim pjesën e linjës _____, pjesa e linjës që do t'i dorëzohet dhe do t'i kalojë në pronësi OST-së, fillon të shtylla nr. _____ deri të shtylla nr. _____, përfshirë shtyllat, bazamentet dhe sipërfaqet e tokës së bazamenteve të shtyllave [i aplikueshëm kur ka dhurim].

c) Brenda një periudhe të arsyeshme nga momenti kur shoqëria ka përmbushur përcaktimet e bëra në nenin 8 dhe 10, si dhe me një njoftim me shkrim të saj, t'i sigurojë shoqërisë akses në rrjetin e transmetimit, për të mundësuar përfundimin e punimeve duke energjizuar nënstacionin _____.

Neni 9

Dorëzimi i pjesës së linjës [i aplikueshëm kur ka dhurim]

1. Kalimi i pronësisë së pjesës së linjës _____ që fillon nga shtylla nr. _____ deri të shtylla nr. _____ përfshirë shtyllat, bazamentet në të cilat janë ndërtuar shtyllat dhe sipërfaqet e tokës së bazamenteve të shtyllave (sipërfaqja e katërkëndëshit që formojnë këmbët e shtyllës plus një metër për anë) do të bëhet menjëherë sapo kjo linjë të jetë përfunduar dhe të jetë gati për përdorim. Ky kalim mund të bëhet edhe më parë, në qoftë se e dikton vullneti i palëve, në çdo rast, kalimi i pronësisë duhet të bëhet përpara se pjesa e linjës dhe nënstacionin në fjalë të energjizohen.

2. Kalimi i pronësisë do të bëhet me kontratë dhurimi, ku shoqëria do të dhurojë dhe OST sh.a. do të pranojë pasuritë e parashikuara në pikën "i" të këtij neni.

Në aneksin 7, pjesë e kësaj marrëveshje, jepet planimetria në të cilën janë paraqitur pjesa e linjës _____, që përfshin shtyllat, bazamentet dhe linjën me gjatësi _____, që do t'i kalojë OST sh.a dhe vlera përkatëse e tyre.

Neni 10

Lidhja me sistemin SCADA, telekomunikacionin dhe komunikimi me Qendrën Kombëtare Dispeçer

1. Përdoruesit e lidhur në rrjetin e transmetimit do të transferojnë të dhënat në kohë reale drejt

Qendrës Kombëtare Dispeçer, duke realizuar lidhjen e detyrueshme dhe telekomunikimin, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në aneksin nr. 4.

2. Shoqëria merr përsipër integrimin e të dhënave të nevojshme të nënstacionit të ri 110/10 kV për kontroll-monitorimin në sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare Dispeçer. Të dhënat e nevojshme për t'u integruar duhet të jenë statuses e çelësave/thikave, alarmet dhe matjet (P, Q, U, I, F) për traktet 110 kV të linjave dhe transformatorëve të këtij nënstacioni, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në aneksin nr. 5.

3. Shoqëria merr përsipër të zbatojë të gjitha detyrimet që lindin nga Kodi i Transmetimit, Kodi i Lidhjes, të cilat përfshijnë por jo vetëm, zbatimin e menjëhershëm të urdhrave të Qendrës Kombëtare Dispeçer, përveç rasteve kur ky veprim mund të rrezikojë sigurinë e personelit ose impiantit.

Neni 11

Testimi, komisionimi dhe energjizimi

1. Pas përfundimit të ndërtimit të aseteve të lidhjes dhe të _____(*objektit*), Përdoruesi do të njoftojë OST sh.a., për të organizuar një grup të përbashkët pune. Roli i OST sh.a. në këtë grup pune është të asistojë gjatë testimit dhe komisionimin të pajisjeve të instaluara, me qëllim lidhjen e centralit prodhues/konsumator, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Mosprezenca e stafit të OST sh.a. gjatë proceseve të testimit dhe komisionimit, i bën të pavlefshme rezultatet.

2. Për qëllimet e kryerjes së testimit dhe komisionimit të aseteve të lidhjes, Përdoruesi vë në dispozicion të OST sh.a. të gjithë dokumentacionin teknik që lidhet me funksionimin e instalimeve të tilla. Ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqipe ose angleze.

3. OST sh.a., gjithashtu, mund t'i kërkojë Përdoruesit që me shpenzimet e tij, të bëjë punë shtesë të paparashikuara në marrëveshje, por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se asetet e lidhjes janë konform specifikimeve dhe kushteve të kësaj marrëveshjeje.

4. Përdoruesi është i detyruar të dorëzojë protokollet e plota të kontrollit dhe testimit të pajisjeve, të kryera në prani të specialistëve të OST sh.a. dhe të firmosura prej tyre, si dhe të dorëzojë pranë OST sh.a., një kopje të protokolleve të pranimit (FAT & SAT), transformatorëve të fuqisë, pajisjeve primare dhe sekondare.

5. Pas përfundimit të testimit dhe komisionimit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, midis përfaqësuesve të OST sh.a. dhe përfaqësuesve të shoqërisë, do të nënshkruhet protokollin i matjes tregtare, të instaluar në anën ____ kV, të transformatorit ngritës të nënstacionit ____ kV.

6. OST sh.a. do të energjizojë nënstacionin lidhës me rrjetin e transmetimit ____ kV, vetëm pasi të jenë plotësuar detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje, si dhe detyrimet përkatëse të përcaktuara në Marrëveshjen e operimit, për lidhjen në rrjetin e transmetimit sipas projektit të miratuar.

Neni 12

Pajtueshmëria dhe njoftimet operacionale

1. Në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes, rregulloren dhe këtë marrëveshje, sipas grafikut të punimeve pjesë e kësaj marrëveshjeje, Përdoruesi do të paraqesë një raport periodik dhe një certifikatë finale performance të infrastrukturës së tij lidhëse me rrjetin e transmetimit, duke shpjeguar përmbushjen në terma sasiorë dhe cilësorë të kërkesave teknike dhe kriterëve operacionale të specifikuar në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, si dhe të kërkesave shtesë të parashikuara me ligj, marrëveshje bilaterale dhe/ose siç kërkohet nga OST sh.a.

2. Procedura operative e njoftimit për lidhjen dhe energjizimin e Përdoruesit do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të kodeve të ENTSO-E (*European Network of Transmission System*

Operators for Electricity), lidhur me kërkesat për centralet prodhuese dhe konsumatorë të energjisë elektrike dhe detajohet si vijon:

- a) Njoftimi Operacional i Energjizimit (EON);
- b) Njoftimi Operacional i Ndërmjetëm/i Përkohshëm (ION);
- c) Njoftimi Operacional Final (FON); dhe
- d) Njoftimi Operacional i Kufizuar (LON).

3. Përdoruesi do të ofrojë asistencën dhe gjithë informacionin e nevojshëm për OST sh.a., për të mbledhur të dhëna për të verifikuar përmbushjen e kërkesave teknike dhe të performancës.

4. Përdoruesi do të kontrollojë me OST sh.a. çështje relevante në një fazë të hershme të projektit në mënyrë që të mundësohen korigjimet e nevojshme para verifikimit të pajtueshmërisë së plotë për efekt të komisionimit dhe të energjizimit final të lidhjes.

5. Grupi përkatës i komisionimit, bashkë me procedurën e njoftimeve operationale, harton edhe lejen teknike, e cila përmban tërësinë e dokumentacionit teknik të përshkruar në Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes.

6. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, shoqëria duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e Marrëveshjes së operimit dhe ta nënshkruajë atë përpara vënies në shfrytëzim normal.

Neni 13

Planifikimi i ndërprerjeve dhe de-energizimi

1. Bazuar në procedurat e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, operatori i sistemit lejohet të kryejë menaxhimin e drejtë të situatave teknike në sistemin elektroenergetik, duke marrë në konsideratë një gamë të gjerë kushtesh operationale, në rrethana normale dhe jonormale, në kushtet e tanishme dhe të një sistemi në të ardhmen. Në Kodin e Rrjetit nuk mund të parashikohen dhe adresohen të gjitha mundësitë operationale, prandaj OST sh.a., në rrethana të paparashikuara në kod, mund të veprojë vendosmërisht në zbatim të detyrimeve të saj.

2. OST sh.a. dhe Përdoruesi duhet të koordinojnë ndërprerjet e planifikuara në rrjet, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, në atë masë që është praktikisht e mundshme dhe e arsyeshme.

3. OST sh.a. dhe Përdoruesi do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që ndërprerjet e tilla do të jenë me kohëzgjatje minimale dhe do të shkaktojnë shqetësime minimale për të tretët dhe nuk do të dëmtojnë funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të sistemit.

4. Pavarësisht nga planifikimi vjetor i ndërprerjeve, OST sh.a. do të mund të kryejë ndërprerje të programuara të detyruara dhe de-energizim të pikës së lidhjes së Përdoruesit, kur kjo kërkohet, me qëllim ushtrimin e funksioneve të saj, me kushtin që të njoftojë këtë të fundit 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara ditës së kryerjes së ndërprerjeve, për ndryshimin e planit të ndërprerjeve dhe për kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruar, sipas rastit.

5. Njoftimi i OST sh.a. do të përfshijë:

- a) Njoftimin dhe arsyetimin;
- b) Planin e ndërprerjeve të përditësuar;
- c) Ndërprerjen e programuar të detyruar, duke specifikuar numrin e pritshëm të ndërprerjeve, kohëzgjatjen në orë dhe datat për secilën pikë lidhjeje ku kryhet ndërprerja.

6. Nëse Përdoruesi pengon OST sh.a. në kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruar, bëhet përgjegjës për të gjitha pasojat dhe kostot që lidhen me vonesat dhe që mund t'i shkaktohen OST sh.a. apo të tretëve me të cilët OST sh.a. është në marrëdhënie kontraktuale.

7. OST sh.a. do të ushtrojë të drejtën e de-energizimit të Përdoruesit në çdo kohë dhe në afatet dhe masën që OST sh.a. e vlerëson proporcionale me situatën, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit ose në ndonjë nga rrethanat e mëposhtme:

- a) Në kushtet e forcës madhore, kur konsiderohet se rrethanat e kërkojnë një masë të tillë;

- b) Për qëllim të realizimit të projekteve për fuqizimin e rrjetit të transmetimit;
- c) Për qëllim të realizimit të lidhjeve të reja të të tretëve në rrjetin e transmetimit;
- d) Me qëllim gjetjen dhe eliminimin e një defekti, për mirëmbajtjen, riparimin ose testimin e një pjese të rrjetit, të cilat janë të nevojshme për të siguruar funksionimin normal dhe për të fuqizuar sigurinë operationale të rrjetit;
- e) Nëse është e nevojshme në një situatë emergjence, në afërsi të rrjetit elektrik ose, në rast nevoje, për të zbutur efektet e çdo rreziku material ose humbjeje financiare për çdo person apo prone të lidhur me ose pranë rrjetit;
- f) Kur kërkohet nga furnizuesi i Përdoruesit, për mospagesë të furnizimit me energji elektrike. Në një rrethanë të tillë, OST sh.a. mund të kërkojë dëshmi të mospagesës nga Përdoruesi;
- g) Kur Përdoruesi nuk përmbush detyrimet në bazë të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe sipas vlerësimit të OST sh.a kjo ka një efekt material të dëmshëm në rrjet;
- h) Në funksion të nenit 17, “Ushtrimi i të drejtave”;
- i) Nëse marrëveshja mes palëve përfundon ose nëse nuk ka dakordësi midis palëve për ndryshime të rrjetit të Përdoruesit (shtesë fuqie, rikonfigurim etj.).

Nëse gjatë kryerjes së punimeve ose gjatë operimit të aseteve të lidhjes, bazuar në një opinion të arsyeshëm të secilës palë, kushtet ose mënyra e veprimit të rrjetit të transmetimit ose, në rast se pjesa e linjës ose nënstacioni shfaq një kërcënim të menjëhershëm për plagosje ose dëme materiale ndaj ndonjë personi ose të rrjetit të transmetimit, ose vetë nënstacionit, OST sh.a. mund të urdhërojë, sipas rastit, personelin operativ të nënstacionit të de-energizojë menjëherë pjesën e linjës dhe të nënstacionin ose OST sh.a. mund të de-energizojë pjesë të rrjetit të transmetimit, në çdo rast, duke iu përmbajtur Kodit të Rrjetit të Transmetimit, nëse është e nevojshme ose e përshtatshme për të shmangur shfaqjen e këtyre plagosjeve ose dëmeve.

8. Në rastet e de-energizimit të një Përdoruesi, OST sh.a. do të dokumentojë shpenzimet që lidhen me de-energizimin dhe do t'i faturojë Përdoruesit këto shpenzime, kur:

- a) De-energizimi është bërë me kërkesën e Përdoruesit;
- b) De-energizimi është bërë në kushtet e nenit 28 dhe Përdoruesi ka qenë shkaktar për nevojën e de-energizimit;
- c) Kur de-energizimi është bërë për shkak të shkeljes së Kodit të Rrjetit të Transmetimit apo të Marrëveshjes së lidhjes, Marrëveshjes së operimit dhe Marrëveshjes së mirëmbajtjes.

9. Kur de-energizimi kërkohet nga furnizuesi i Përdoruesit, OST sh.a. do t'i faturojë shpenzimet në lidhje me de-energizimin, furnizuesit të Përdoruesit.

10. OST sh.a. do të rienergizojë sa më parë që të jetë e mundur Përdoruesin kur ka të dhëna që rrethanat që çuan në de-energizim nuk ekzistojnë më apo ka garanci të dokumentuar që rrethanat nuk do të përsëriten;

11. OST sh.a. mund të kërkojë nga Përdoruesi i prekur nga de-energizimi, prova të arsyeshme ose kryerjen e testeve, për të verifikuar që shkaqet e de-energizimit janë adresuar apo nuk ekzistojnë më. Testimet e nevojshme mund të realizohen nga ana e vetë Përdoruesit, nga të tretë ose të do të lejohet të kryhen nga OST sh.a..

12. Kur verifikimi apo testimet kryhen nga OST sh.a., Përdoruesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e kostove përkatëse.

13. Rienergizimi do të kryhet me koordinimin e të dyja palëve, duke garantuar sigurinë e operimit të sistemit dhe duke shmangur efektet shqetësuese për të tretët.

14. Kostot për rienergizimin alokohen në të njëjtën mënyrë si kostot e de-energizimit.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë si Përdorues i lidhjes

1. Pas lidhjes së _____ (*objektit*), në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes e operimit dhe të Marrëveshjes së transmetimit (kur është e aplikueshme), shoqëria fiton të drejtën për të injektuar/për të marrë energji elektrike në/nga rrjeti i transmetimit, në përputhje me fuqinë e instaluar të deklaruar dhe në përputhje me:

- a) Rregullat teknike për lidhje të përcaktuara nga OST sh.a.;
- b) Kushtet teknike dhe ekonomike të aksesit dhe interkoneksionit në rrjet, të përcaktuara nga autoriteti;
- c) Rregullat e dispeçerimit të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit;
- d) Kërkesat e tjera të përcaktuara në lidhjen me rrjetin e transmetimit, të cilat janë të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

2. Përdoruesi i lidhjes nuk mund të injektojë/të marrë në/nga rrjeti një fuqi më të lartë se ajo e përcaktuar në ofertën e lidhjes.

Neni 15

Transferimi i marrëveshjes

1. Në rast se Përdoruesi do t'ia transferojë këtë marrëveshje të tretëve, duhet të plotësojë më parë këto kushte:

- a) Pala e tretë duhet të jetë e pajisur me licencat e nevojshme nga Enti Rregullator i Energjisë;
- b) Të dokumentojë shlyerjen e çdo detyrimi ndaj OST sh.a.;
- c) Të ketë njoftuar me shkrim OST sh.a., 3 (tre) muaj përpara ekzekutimit të transferimit.

Neni 16

Forca madhore

1. Me përjashtim të rasteve shprehimisht të parashikuara në këtë Marrëveshje, asnjë Palë nuk do të konsiderohet në shkellje të kësaj Marrëveshjeje, në qoftë se provon që moszbatimi i detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje është i shkaktuar nga një rast force madhore. Forcë madhore është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si: tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmytjet, thatësira e tejzgjatur, prurja me plota të mëdha, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë palët të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre dhe palët nuk janë në gjendje t'i eliminojnë ato, edhe pse kanë ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tyre.

2. Në qoftë se çdo palë është në pamundësi të përmbushë ndonjë ose të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje, për shkak të një ngjarje të forcës madhore, kjo marrëveshje do të jetë në fuqi, por:

a) Detyrimet përkatëse të palës mos-përmbushëse do të pezullohen për një periudhë të barabartë me ngjarjen ose rrethanën e forcës madhore.

b) Detyrimet e Palës tjetër që i detyrohet palës mospërmbushëse sipas kësaj marrëveshjeje, të cilat pala tjetër është e pamundur t'i përmbushë drejtpërdrejt, si rezultat i pezullimit të detyrimeve të palës mospërmbushëse, do të pezullohen për një periudhë të barabartë me ngjarjen ose rrethanat e forcës madhore, duke pranuar që:

i) Pezullimi i përmbushjes është i një qëllimi jo më të madh dhe i një kohëzgjatjeje jo më të madhe se sa kërkohet për forcën madhore;

ii) Asnjë detyrim i secilës palë, i lindur përpara forcës madhore, duke shkaktuar pezullimin e përmbushjes, nuk do të anashkalohet si rezultat i forcës madhore;

iii) Pala në mospërbushje njofton menjëherë palën tjetër për ngjarjen ose rrethanën e forcës madhore, duke përfshirë natyrën dhe kohëzgjatjen e pritshme, si dhe vazhdon t'i raportojë rregullisht në lidhje me to gjatë periudhës së forcës madhore;

iv) Pala mospërbushëse përdor të gjitha mundësitë e arsyeshme për të parandaluar, për të shmangur ose për të zbutur pasojat e forcës;

v) Menjëherë pas shfaqjes së ngjarjes ose rrethanave të forcës madhore, Palët do të diskutojnë për të vazhduar veprimet e tyre, sa më mirë dhe sa më gjatë të jetë e mundur, në përputhje me këtë marrëveshje dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

Neni 17

Rastet e mospërbushjes

1. Nëse konstatohet se Përdoruesi është në shkelje/mospërbushje të ndonjë prej dispozitave të marrëveshjes, Kodit të Rrjetit të Transmetimit apo kuadrit ligjor, atëherë OST sh.a., në përputhje me kompetencat e saj, sa më shpejt që është e mundur, do të njoftojë Përdoruesin duke udhëzuar atë për eliminimin e tyre dhe duke përcaktuar afatet përkatëse për këtë qëllim.

2. Në vijim të njoftimit nga OST sh.a. dhe të zbatimit të udhëzimeve për eliminimin e shkeljes/e mospërbushjes nga ana e Përdoruesit, Përdoruesi do të njoftojë OST sh.a., brenda afatit të caktuar në udhëzimet e dhëna prej saj ose brenda 5 ditëve pune nëse OST sh.a. nuk ka specifikuar afat tjetër, për hapat e ndërmarrë për eliminimin e shkeljes ose eliminimin përfundimtar të saj ose paaftësinë për të eliminuar shkeljen.

3. Nëse Përdoruesi nuk vepron në përputhje me udhëzimin e OST sh.a., standardet e sigurisë, Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Marrëveshjen e lidhjes dhe operimit, OST sh.a. do të japë një njoftim të dytë paralajmërues me shkrim dhe do të procedojë me de-energizimin, pas kalimit të së paku 7 (shtatë) ditëve nga ky njoftim, me kusht që në kohën e skadimit të njoftimit, Përdoruesi ende nuk ka vepruar në përputhje me udhëzimet e OST sh.a..

4. Përfundimisht, nga sa parashikohet më lart, kur Përdoruesi nuk përmbush detyrimet e tij sipas kushteve të kësaj marrëveshjeJE dhe OST sh.a. e vlerëson të nevojshme ushtrimin emergjent të funksioneve të saj, ka të drejtë të de-energizojë menjëherë nënstacionin dhe të njoftojë me shkrim Përdoruesin për shkaqet e këtij de-energizimi. Përdoruesi, në këtë rast do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara OST sh.a. dhe do të marrë masat për korrigjimin e situatës dhe/ose përmbushjen e detyrimeve të saj, sa më shpejt të jetë e mundur. De-energizimi do të vazhdojë deri sa Përdoruesi të korrigjojë situatën dhe/ose të përmbushë detyrimet e tij.

Neni 18

Zgjidhja e Marrëveshjes

1. OST sh.a. ka të drejtë, në çdo kohë, të zgjidhë marrëveshjen, nëse verifikohet çdonjëra nga sjelljet e mëposhtme:

a) Shoqëria nuk respekton përcaktimet e bëra në këtë marrëveshje, në ofertën e lidhjes dhe projektzbatimin përfundimtar të pranuar nga OST sh.a.;

b) Pezullimi i një ose më shumë lejeve për qasje dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit;

c) Dështimi për të ndjekur kushtet teknike dhe ekonomike të lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe interkoneksionit;

d) Dështimi për të përmbushur detyrimet për informim të OST sh.a.;

e) Çdo sjellje tjetër që mund të rrezikojë sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimit të operimit të rrjetit elektrik ose është në mënyrë të qartë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Rrjetit.

2. Në raste të tilla, shkëputja fizike do të bëhet pas përfundimit të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas nenit të sipërpërmendur.

3. Shoqëria në këtë rast do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara OST sh.a.

Neni 19

Konfidencialiteti

1. Secila nga Palët merr përsipër që të ruajë sekret përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje dhe kushtet e saj, si dhe çdo informacion dhe dokument që palët kanë shkëmbyer ose kanë marrë dijeni gjatë negociemeve të kësaj marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur bërja publike e sa më sipër është kërkesë e ligjeve shqiptare.

2. Detyrimi për të ruajtur sekret informacionet e marra si më sipër për secilën nga palët në këtë marrëveshje vazhdon edhe pas zgjidhjes së saj.

Neni 20

Njoftimet

1. Përveç sa është parashikuar ndryshe në nenet e tjera të kësaj marrëveshjeje, çdo komunikim sipas saj do të bëhet me shkrim dhe do të njoftohet me letër rekomande (njoftim marrjeje), në adresat e përcaktuara më poshtë:

Për OST sh.a., në:

Adresa: OST sh.a.

Adresa postare: Autostrada Tiranë–Durrës, km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë, Shqipëri

Numri i telefonit: +355 4 2225581

Adresa e postës elektronike: info@ost.al

Në vëmendje të: Administratorit të OST sh.a.

Për Përdoruesin, në:

Adresa:

Adresa postare:

Numri i telefonit:

Adresa e postës elektronike:

Në vëmendje të: Përfaqësuesit ligjor të Përdoruesit

ose në adresën dhe/ose numrin e faksit që u komunikohet palëve sipas mënyrës së përcaktuar më sipër.

2. Çdo komunikim i drejtuar në adresat e mësipërme dhe i kryer sipas mënyrës sa më sipër përcaktuar është i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët. Komunikimet konsiderohen të kryera në mënyrë të vlefshme në momentin e marrjes së letrës rekomande nga marrësi, sipas mënyrës së përcaktuar më sipër.

Neni 21

Ndryshimet

1. Çdo ndryshim i mundshëm i ndonjë kushti të kësaj marrëveshjeje ose të një të drejte që rrjedh nga kjo marrëveshje, do të jetë i vlefshëm nëse do të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga palët ose nëse ndryshimet e propozuara miratohen nga ERE.

2. Secila nga palët ka të drejtë të njoftojë palën tjetër për t'i rekomanduar këto ndryshime në marrëveshje, herë pas here, pasi janë të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, licencave përkatëse që ato kanë, si dhe akteve të tjera relevante.

Neni 22

Ndashmëria

1. Çdo nen, dispozitë, seksion, paragraf apo nënndarje e kësaj marrëveshjeje që është ose do të

shpallet i pavlefshëm ose i paefektshme, do të hiqet nga kjo marrëveshje, nuk do të zbatohet dhe nuk do të ndikojë, në asnjë mënyrë, në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje, për aq sa lejohet nga dispozitat ligjore.

Neni 23

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me të.

2. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin si pasojë e interpretimit dhe e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, kur kanë të bëjnë me interpretimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, do të zgjidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në të. Në çdo rast tjetër, palët do të mundohen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim midis tyre dhe kur kjo është e pamundur, mosmarrëveshjet, kur nuk u nënshtrohen dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24

Gjuha

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje, të gjitha njoftimet, ose dokumente të tjera që njëra nga palët i jep palës tjetër sipas kësaj marrëveshjeje, do të jenë në gjuhën shqipe.

2. Kjo marrëveshje është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, ku tri kopje i mban OST sh.a. dhe një kopje Përdoruesi.

OST sh.a.

Nga: Z. _____

Titulli: Administrator i OST sh.a.

Përdoruesi

Nga: Z. _____

Titulli: Përfaqësues ligjor i Përdoruesit

Aneksi nr. 1. Dokumentacioni teknik i lidhjes me rrjetin kombëtar të transmetimit

Aneksi nr. 2. Licenca e prodhimit të energjisë elektrike, e lëshuar nga ERE

Aneksi nr. 3. Specifikimet teknike të sistemit të matjes tregtare

Aneksi nr. 4. Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin e telekomunikacionit

Aneksi nr. 5. Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin e SCADA-s të Qendrës Kombëtare

Dispeçer

Aneksi nr. 6. Deklaratat e përgjegjësisë dhe gatishmërisë

Aneksi nr. 7. Dorëzimi i pjesës së linjës